



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Inxhinieri Ndërtimi” me profil “Strukturë”
ofruar nga
Universiteti “Polis”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc. Dr. Fisnik Kadiu
2. Prof. Asoc. Dr. Gafur Muka

Maj/ 2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil “Strukturë” ofruar nga Universiteti “Polis”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Polis”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil “Strukturë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 432, date 12.11.2015
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 12, datë 30.08.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike /4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: (2023- 2024)	7 PAE/ 4 PAK
18	Numri i studentëve: (2022- 2024)	58 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturë, menaxhohet nga Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajn, në Universitetin POLIS në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Vendimi nr.424, datë 02.06.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë". Programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me qëllimin e objektivat e tij dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare të zhvillimit të arsimit të lartë dhe të tregut të punës.

Ky program studimi ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2015 kohëzgjatja është 2 vite akademike me 120 kredite, gjuha e zhvillimit të programit të studimit është gjuha shqipe.

Me shkresë Nr 741/ 23 datë 09.10.2023, Universiteti Polis ka kërkuar mos aktivizimin e profilit "Gjeoteknikë" pasi nuk ka patur studentë të regjistruar.

Ky vendim është miratuar edhe me Vendim Senati nr. 26, datë 06.10.2023

Universiteti POLIS për rritjen e nivelit të mësimdhënies ka rekrutuar staf akademik me eksperiencë profesionale në përputhje me kërkesat e këtij programi e studimi.

Për studentët e tij, Universiteti POLIS ka siguruar një infrastrukturë bashkëkohore (auditore, laboratore, biblioteka, zyra etj.) të mjaftueshme për zhvillimin normal të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturë. Strukturë akademike dhe ndihmës akademike mbështet studentët dhe stafin akademik në ecurinë e tyre nëpërmjet zbatimit të akteve dhe rregullave të brendshme duke garantuar barazi dhe transparencë të të gjitha proceseve të përfshira në Universitetin POLIS. Kështu, dallon përfshirja e studentëve në vendimmarrje në të gjitha nivelet për kontributin e tyre për cilësinë e mësimdhënies. Universiteti POLIS tregon vëmëndje të veçantë duke mbështetur studentët edhe pas përfundimit të ciklit të studimeve nëpërmjet rrjetit Alumni, i cili është mjaft aktiv nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë me shoqëri private, institucione shtetërore të fushës të ndërtimit etj.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

ASCAL ka përcaktuar afatet dhe grupin e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili "Strukturë". Në Datën 20.11.2023, Ekspertet të vlerësimit të jashtëm janë caktuar:

1. Prof As. Fisnik Kadiu
2. Prof As. Gafur Muka

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc. Aviola Bardhi.

Nëpërmjet sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju është vënë në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësimin e programit të studimit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit ekspertët kanë përgatitur draft raportin dhe kanë hartuar një game pyetjesh të cilat ndihmuan në qartësimin e disa çështjeve që lidhen me përgatitjen e këtij raporti.

Gjatë vizitës së kryer në Universitetin POLIS, në data 17 dhe 18 Janar 2024, GVJ kreu takime me përfaqësues të Universitetit POLIS, Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajn dhe Departamentin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit, stafit mësimorë, studentët, sekretarinë mësimore, Grupin e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë, Bibliotekën e Universitetit dhe bëri vizita në laboratore, salla mësimi të leksioneve e seminareve etj.

Këto takime u shoqëruan me diskutime dhe shkëmbim të mendimeve në interes të palëve dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili shpreh mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi. Raporti mbyllet me një analizë përmbledhëse për anët e forta dhe të dobta lidhur me programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi, profili "Strukturë".

Grupi i Vlerësimit të jashtëm (GVJ) i është përgjigjur kërkesave të çdo standardi dhe kriterëve të tyre nëse plotësohen apo jo dhe për shkallën e vlerësimit.

Më datë 22.04.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr 26/2 Prot., datë 22.04.2024 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 30.04.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr 399/24 Prot., datë 29.04.2024, ardhur në protokollin e ASCAL më datë 02.05.2024.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft- raportin, sqaron si vijon:

Lidhur me komentin për standardin IV.1, kriteri 1

Nga verifikimi rezulton që lëndët që kanë si titullar personel akademik me gradë shkencore Msc jepen në ciklin Bachelor sipas kërkesës së ligjit 80/2015, neni 59 pika 6.

Sidoqoftë angazhimi i personelit me gradë shkencore Msc në këtë program studimi nuk është plotësisht në përmbushje të kërkesës së ligjit 80/2015, neni 59 pika 6 prandaj GVJ rekomandon që institucioni ta konsiderojë këtë konstatim.

Ky vlerësim pasqyrohet në draft- Raportin e GVJ.



Lidhur me komentën për standardin IV.1, kriteri 3

Arsyetimi që reduktimi i PAE ka ardhur si rezultat i moshapjes së profilit “Gjeoteknikë” për vitin 2023-2024 është i drejtë dhe i mbështetur. Shqetësimi qëndron tek shpërndarja e ngarkesës mësimore pasi, si pasojë e këtij reduktimi del që ajo në të gjitha rastet është më e madhe se norma e përcaktuar në udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 të MASR. Në tre raste për pozicionin e lektorit ajo e kalon edhe masën e normës+200 orë suplementare. Po ashtu ky tejkallim rezultoi, në këtë masë, edhe në dy raste për gradën Msc. (Natyrishment që për të dy rastet nuk kalohet masa e 300 orëve suplementare e cila, sipas udhëzimit të cituar, lejohet në raste specifike). Nisur nga këto të dhëna GVJ rekomandon përmirësime në këtë drejtim duke rritur numrin e PAE dhe zvogëluar ngarkesën e tij në auditor.

Ky vlerësim pasqyrohet në draft- Raportin e GVJ.

Lidhur me shkallën e përmbushjes së rekomandimeve nga akreditimi i fundit
GVJ është dakord me saktësimin e bërë nga institucioni.

Ky vlerësim pasqyrohet në draft- Raportin e GVJ.

Lidhur me komentën për standardin II.6, kriteri 3
- GVJ është dakord me saktësimin e bërë nga institucioni.

Ky vlerësim pasqyrohet në draft- Raportin e GVJ.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 12, datë 30.08.2018 janë:

1. Për të ardhmen rekomandohet që të veçohen Rezultatet e Nxënies (learning outcomes) nga Objektivat për secilën lëndë mësimore nga të cilat do të identifikoheshin kompetencat e profesionit.
2. Pas përfundimit të praktikës, studenti fiton 6 ECTS dhe nuk vlerësohet me notë (6 ECTS nuk hyjnë në notën përfundimtare të studimeve). Sipas Bolonjës, të gjitha lëndët/modulet (kreditë të fituara) duhet të jenë vlerësuar me notë, prandaj Institucioni rekomandohet që praktikën profesionale t'a vlerësojë me notë.
3. Rekomandojmë të zvoglohen kreditet në grupin e lëndëve në D, duke ju dhënë studentëve hapsirë më të madhe në lëndë zgjedhore në semestrin e parë të vitit të dytë, dhe në këtë rast do të duhej të zvoglohen lëndët teorike nga 6 ECTS në 3 ECTS ndërsa të rritet numuri i lëndëve-fushave profesionale dhe sidomos të menaxhimit.
4. Rritja e lëndëve në gjuhën angleze për tërë programin e studimit do të ishte në favor të studentëve për integrimin e tyre në tregun e punës Evropian dhe Ndërkombëtar, pasi që ky program ka objektiv edhe tregun e Evropës.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni


1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajn dhe Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, kanë përditësuar formatet e silabuseve të lëndëve të programit të studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të Këshillit të Ministrave. GVJ konsultoi edhe përditësimin elektronik në platformën Pitagora të formatit të silabuseve të lëndëve të programit të studimit Master i Shkencës në Inxhinieri Ndërtimi.

2. Praktika mësimore si pjesë e programit të studimit është disiplinë e grupit D, e detyrueshme dhe zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë me kohëzgjatje 3 mujore. Në kurrikulat e programit Master Shkencor me kohë të plotë për praktikën mësimore janë të parashikuara 9 kredite/180 orë; të barasvlefshme me 12 javë mësimore.

Gjatë takimeve me Dekanin, Përgjegjës të Departamentit, Stafin akademik, Studentët etj., GVJ konstaton se për mbarëvajtjen e gjithë periudhës së Internshipit Profesional ka caktuar një pedagog madje, për këtë qëllim është hartuar edhe një procedurë e re për vlerësimin e studentëve nga ana e pedagogut përgjegjës, i cili i bashkëngjitet Formatit të angazhimit në Internship i firmosuar nga Dekani i Fakultetit. Nëpërmjet këtij argumentimi studentët që kryejnë praktikën mësimore të mos bëhet me note, pasi ata gjatë gjithë periudhës së internshipit i nënshtrohen kontrolleve të vazhdueshme, që stafi përgjegjës kryen gjatë gjithë periudhës për çdo student praktikant, janë të mjaftueshme për bërë një vlerësim të studentëve dhe internshipit në funksion të përmbushjes me sukses të këtij procesi.

3. Bazuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të Këshillit të Ministrave, Shtojca 1, lëndët e përfshira në disiplinën e tipit D, për programet e studimit Master Shkencor duhet të jenë në peshën 10%. Programi i Studimit Master në Inxhinieri Ndërtimi e plotëson këtë kërkesë me dy lëndët 1. Internship Profesional (9 kredite ECTS) dhe 2. Themelet me Pilota (3 kredite ECTS). Rekomandimi plotësohet.

4. Lidhur me përdorimin e gjuhës angleze në lëndët, GVJ konstaton se me vendim të Senatit, liria akademike e çdo pedagogu është zgjedhje individuale për të zhvilluar lëndën në gjuhën angleze. Gjithashtu, përdorimi i gjuhës angleze ndodh sa herë që Departamenti fton lektorë të huaj për zhvillimin e leksioneve të hapura apo workshopeve disa ditore me studentët e këtij programi studimi. (Aneksi 51, Plan Veprimi i Programit “Master i Shkencave” në Inxhinieri Ndërtimi me profile “Strukturë “dhe “Gjeoteknikë”). Përveç workshopeve vjetore, që zhvillohen në kuadër të javës së arkitekturës dhe dizajnit (Tirana Architecture/Design week), në çdo vit akademik është bërë traditë zhvillimi i të paktën një workshopi ekstrakurrikular në gjuhën angleze, ku trajtohen tematika të ndryshme lidhur me të rejat në fushën e ndërtimit, projektimit të Strukturave prej betoni të armuar, mbi konceptet dhe Strukturat prej druri si dhe aplikimi i gjerë i programeve BIM në anglisht për sektorin e ndërtimit. Si përfundim GVJ vleron qw wshtw rritur pesha e gjuhws angleze nw realizmin e planit mwsimor duke plotwsuar kwshtu edhe rekomandimin 4.



Vlerësimi i programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil “Strukturë” në Universiteti “Polis”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Gjatë konsultimit me dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit (RVB) si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion (Minutat e takimeve), GVJ ka krijuar bindjen se programi i studimit Master në "Inxhinieri Ndërtimi", profili i studimeve "Strukturë" ofron një kurrikul mësimore konkurrues, programe lëndësh të përditësuara e me nivel pedagogjik e shkencor të konsoliduar dhe infrastrukturë të përshtatshme. Cilësia e produktit i përgjigjet kërkesave që kërkon tregu i punës. Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare, përkundazi ai është i konceptuar në përputhje edhe me vizionin e Universitetit Polis, sipas edhe përvojës së deritanishme ka treguar integritet në përputhshmëri me kërkesat e komunitetit të fushës së ndërtimit. Programi i studimit Master i Shkencës në "Inxhinieri Ndërtimi", deri më sot ka treguar se edhe në vijim garanton se është për ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të vlerave akademike e kulturore kombëtare dhe integritetit funksional në fushën e profesionistëve të ndërtimit. Referenca: RVB. Dhjetor 2023, Program i Studimit, Cikli i dytë, MSH Inxhinieri Ndërtimi- "Strukturë"; Shenime në takime.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ konstaton se të gjitha kurrikulat aktuale dhe syllabuset e lëndëve të njësisë bazë, janë në përputhje të plotë edhe me misionin dhe planet strategjike të Univeritetit Polis. Programi është konkurrues edhe në kuadrin kombëtar; me synimin të mbetet i tillë edhe në fushën e veprimtarisë edhe në të ardhmen. Referenca: Aneksi 1, Statuti I Universitetit POLIS; Aneksi 6, Rregullore e programit të studimit; Shënime nga vizita në Institucion
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut, i cili përfshin mundësinë e punësimit të studentëve në tregun, vëndas rajonal e kombëtarë apo edhe ndërkombëtar rajonal. Referuar planit strategjik të Universitetit Polis, GVJ konstaton që Programi i studimeve në "Inxhinieri Ndërtimi", profili "Strukturë" ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të statutit dhe Rregullores së Universitetit Polis. Referenca: Aneksi 6, Rregullore e studimit; Aneksi 2, Strategjia e zhvillimit të Universitetit POLIS (2021-2026); Aneksi 12, Strategjia e zhvillimit të programit (2021-2026); Shënime nga vizita në Institucion
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në	Programi Master i Shkencës në "Inxhinieri Ndërtimi" përputhet plotësisht me kriteret e përcaktuara dhe aktet ligjore që janë në fuqi. Njëkohësisht programi i studimit është konceptuar në respektim dhe zbatim të ligjit për Arsimin e Lartë si dhe në akte të tjera për të patur pajtueshmëri me to. IAL ka miratuar strategji të zhvillimit të miratuar nga Senati Akademik ku Universiteti dhe njësitë e saj janë të përcaktuara për programe akademike të avancuara dhe bashkëkohore në mënyrë që t'u afrojë

dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	studentëve prioritet në dokumentacionin vendas por edhe në atë ndërkombëtar.			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili "Strukturë", ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të statutit dhe Rregullores së Universitetit Polis. Programi i studimit është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit dhe me aktet ligjore. Programi i studimit garanton se është për ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të vlerave akademike e kulturore kombëtare dhe integritet funksional në fushën e profesionistëve të ndërtimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Universiteti Polis, deri në momentin që kryhet ky vlerësim për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili "Strukturë", ka treguar qëndrueshmëri institucionale falë përvojës së gjatë të tij dhe kapaciteteve akademike dhe organizative.</p> <p>Hartimi dhe mirë funksionimi i rregulloreve të brendshme dhe ngritja e organeve kolegjiale të funksionimit e marrjes së vendimeve dhe zbatimit të tyre, tregon se ka kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të ofruar programe studimi në fushën e "Inxhinierisë së Ndërtimit", profili "Master i Shkencës" ia kanë arritur qëllimit.</p> <p>Në mbarëvajtjen e këtij programi studimi kanë ndikuar drejtëpërsëdrejti dhe funksionimi i njësisë akademike të Fakulteteve, Departamenteve të plotësuara më së miri me rregulloret e brendshme, që kanë siguruar një ecuri bindëse institucionale;</p> <p>Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë ka kapacitete dhe burime të mjaftueshme akademike për stafin me kohë të plotë dhe atë me kontratë për të vazhduar normalisht këtë program studimi. Departamenti i Arkitekturës dhe i Inxhinierisë për vitin akademik 2023-2024 ka në përbërjen e tij (30) personel në total, të ndara si vijon: (PAE) - Prof.asoc: 1; (Doc) Doktor: 2; Doktor: 8; Dr. proc.5; MSc: 5 dhe (PAK) Doktor:2; MSc:7.</p> <p>GVJ, vlerëson pozitivisht dhe kapacitetet mjediseve si auditore, klasa për zhvillimin e leksioneve dhe siminareve, laboratore për kryerjen testimeve për disa materiale të ndërtimit, laboratore të informatikës, bibliotekë, zyra për informim të studentëve dhe të infrastrukturës (1799 m², kati Zero); (1801m² kati i parë); (1541m² kati i dytë); (615m², kati i tretë), me një sipërfaqe të përgjithshme 11.020m².</p> <p>GVJ, vlerëson se Universiteti Polis i ka të gjitha burimet dhe kapacitetet për vazhdimin e programit të studimit të ciklit të studimit "Master i Shkencave" në Inxhinieri Ndërtimi, me profil "Strukturë".</p>

	<p>Referenca: Evidencë 4 (tabelat e përditësuara); Evidencë 14 (Të dhëna të përgjithshme për infrastrukturën, Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme ashtu dhe ajo specifike e programit të studimit Master i Shkencës në "Inxhinieri Ndërtimi", me profil "Strukturë", është në përputhje të plotë me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajn me këto njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti "Art dhe Dizajn" 2. Departamenti "Arkitekturë dhe Inxhinieri" 3. Qendra kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn <p>Lëndët dhe programet e studimit në tërësinë e tyre janë të kodifikuara sipas dispozitave të nenit 80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencorë" në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë të miratuara nga "Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë".</p> <p>Referenca: Aneksi 1, Statuti i Universitetit POLIS; Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencës në "Inxhinieri Ndërtimi" me profil "Strukturë" ofrohet bazuar në Ligjin Shqiptar dhe në përputhje me Strategjinë dhe planin e Zhvillimit të Universitetit Polis dhe Departamenti (Aneksi 1, Statuti i Universitetit POLIS) ofron programe studimi në nivelin Bachelor dhe Master. Departamenti, është Ai që mirëpret studentët, të cilët dëshirojnë të ndjekin e studiojnë për programet e studimit në përputhje me kërkesat e legjisllacionit të arsimit të lartë në Shqipëri si edhe me procesin Evropian të Bolonjës e Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master në Inxhinieri Ndërtimi" është në përputhje me fushën kërkimore dhe akademike të Departamentit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë.</p> <p>Referenca: Aneksi 1, Statuti i Universitetit POLIS; Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky kriter i këtij standardi nuk aplikohet për këtë program studimi</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Universiteti POLIS zhvillon në mënyrë të programuar trajnime me partner të huaj. Pjesë e këtyre cikleve kanë qenë dhe trajnimet IDEA në kuadër të projektit "Inclusive Tertiary Education Education in West Balcans; trajnimi i stafit dhe studentëve nga VTECH for Accelerating Western Balcans University Modernization by Incorporating Virtual Technologies. Gjithashtu ky Universitet mbështet studentët për pjesëmarrjen dhe trajnimin e tyre nëpërmjet tre kurseve me karakter teorik e praktik me të drejtë licensimi.</p> <p>Referenca: RVB, Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë kanë kapacitete dhe burime të mjaftueshme akademike; staf me kohë të plotë dhe me kontratë për të përballuar normalisht këtë program studimi. Programi i studimit Master i Shkencës në "Inxhinieri Ndërtimi" me profil "Strukturë" ofrohet bazuar</i></p>

	<i>në Ligjin Shqiptar, në përputhje me Strategjinë dhe planin e Zhvillimit të Universitetit Polis dhe Departamentit. Universiteti mbështet studentët për pjesëmarrjen dhe trajnimin e tyre nëpërmjet kurseve me karakter teorik e praktik me të drejtë licensimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Realizimi i këtij programi studimi mbështet nga një staf burimesh njerëzore i kualifikuar si në drejtim akademik ashtu edhe në atë administrativ e institucional. Në përmbushje të këtij kriteri GVJ pasi është konsultuar me RVB dhe informacionet plotësuese gjatë vizitës vlerësuese konstaton se në Universitetin POLIS ka marrëdhënie të mira bashkëpunimi e funksionale ndërmjet të gjitha njësive kryesore dhe atyre bazë brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit. Kështu, departamenti merr masat që personeli akademik me kohë të plotë (PAE) të realizojë orët mësimore sipas planit mësimorë akademik ndërsa personeli ndihmës administrativ të jetë në shërbim vazhdueshëm për të krijuar kushte optimale për realizimin e programit mësimorë dhe të detyrimeve që rrjedhin prej tij. GVJ, gjatw takimeve me stafin dhe studentët vëren se ka një bashkëpunim miis tyre në aktivitete të kërkimeve shkencore, në trajnime të përbashkëta, në objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe përdorimin e mjediseve të përbashkëta. GVJ konstaton se ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efektiv.</p> <p>Referenca: Aneksi 30, Tabela 5- Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në nivel program: Shënimet e takimeve gjatë vizitës në Institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Departamenti i Arkitekturës dhe i Inxhinierisë, në funksioin të studimit ka lidhje bashkëpunimi me institucione brenda e jashtë vendit, si dhe kompani të biznesit, vendas e të huaj për realizimin e objektivave të procesit mësimor të studentëve. GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimeve me përfaqësuesit e zyrës së projekteve e marrëdhënieve ndërkombëtare, ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet, duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme. Aktualisht ne 7 (shtatë) projekte ndërkombëtare janë përfshirë pedagogë dhe studentë, Me këto partner ekzistojnë marrëveshje të nënshkruara, të cilat përfshijnë edhe fushën e inxhinierisë së ndërtimit. Disa prej këtyre projekteve janë.</p> <p>1.Projekti DRIVE 610307-EPP-1-AL- EPPKA2-CBHE-JP “Zhvillimi i KapaKërkimit dhe Inovacionit Developing Research and Innovation Capacities in Albania and Kosovo”;</p> <p>2.Projekti COST CA16114 “Rikonceptimi qëndrueshmërisë nëpërmjet ekonomive regenerative” (RESTORE”;</p>

	<p>3. Erasmus KA 1, Program shkëmbimi për staf dhe student mes mes Universitetit POLIS dhe Universitetit të Minho-s Portugali;</p> <p>4. Erasmus KA 1, Program shkëmbimi për staf dhe student mes mes Universitetit POLIS dhe Universitetit Politeknik të Barit, Itali;</p> <p>5. Erasmus KA 1, Program shkëmbimi për staf dhe student mes mes Universitetit POLIS dhe Universitetit të Molise, Itali;</p> <p>6. Programi TEMPUS/Projekti DAPEEËB (Kordinator i Universitetit POLIS): “Zhvillimi dhe përshtatja e Programeve Profesionale mbi Eficiencën Energjitike në Ballkanin Perëndimor”</p> <p>7. Programi TEMPUS/Projekti CONSUS (Kordinator Karl-Franzens-University of Graz, Atria).</p> <p>Referenca: Aneksi 37, Lista e e projekteve ndërkombëtare; Minutat e takimeve gjatë vizitës në Institucion.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve me institucione të ndryshme dhe në planin mësimorë të çdo viti akademik janë të parashikuara zhvillimi i praktikave profesionale përpara hartimit të diplomave. Lista e Institucioneve që IAL për programin e studimit Master i Shkencës në Inxhinieri Ndërtimi bashkëpunon me 27 (njëzeteshtatë) kompani, çka dëshmon se edhe përzgjedhja e tyre me profilin e studimeve ka qenë e drejtë dhe me efektivitet (Aneksi 6, Lista e kompanive të bashkëpunimit).</p> <p>Për këtë program studimi ka pedagog mbikqyrës dhe koordinues (Dr. Ornela Sen) për të gjithë periudhën e zhvillimit të praktikave (një procedurë e re për vlerësimin e Internshipit profesional); ngë ata shërbejnë edhe si ndërmjetës të institucionit me kompanitë ku studentët zhvillojnë praktikat; gjë që pasyrohet edhe në formularët dhe raportet respektive për vlerësimin e studentëve, të cilat bëhen pjesë e dosjes së vlerësimit të studentëve</p> <p>Referencë: Evidenca 5 (Marrëveshshjet e bashkëpunimit në MSc Inxhinieri ndërtimi); Evidenca 6(Lista e kompanive të bashkëpunimit); Evidenca 12 (Shpjegim për përmbushjen e rekomandimeve).</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se në çdo fundviti akademik departamenti i Arkitekturës dhe i Inxhinirisë, përgjegjës për këtë program studimi dhe në funksion të realizimit të tij, harton raporte analitike mbi marrëveshjet e bashkëpunimit; për vitin 2023-24, 8 (tetë) me institucionet homologe të huaja dhe vendase për të cilat kanë patur interes dhe përfitime (Evidenca 5, Marrëveshjet e bashkëpunimit). Gjithashtu, praktikat vlerësohen nga një komision i veçantë dhe nga vetë studentët me anë të një formulari, nga i cili merret një informacion në lidhje me efektshmërinë e realizimit të praktikave.</p> <p>Referencë: Aneksi 25 (Politikat e bashkëpunimit); Evidenca 5 (Marrëveshjet e bashkëpunimit); Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Universiteti POLIS në funksion të realizimit të programit të këtij studimit ka krijuar lidhje të qëndrueshme bashkëpunimi me shumë institucione brenda e jashtë vendit, për realizimin e objektivave të procesit mësimor. Në planin mësimorë parashikohen zhvillimi i praktikave profesionale me pedagogë mbikqyrës, një zgjidhje tepër efektive për vlerësimin e studentëve në përfundim të saj; apo përzgjedhja</i></p>

	<i>e labororit privat të Akredituar ALTEA & Gjeostudio 2000 për zhvillimin e disa punëve laboratorike që nuk mund të kryen në universiteti POLIS; krijuan bindjen e GVJ se realizimi i programit mësimorë Master i Shkencës në Inxhinieri Ndërtimi – “Strukturë” është e garantuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ vlerëson se program i ciklit të dytë të studimit në Master Shkencorë në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil “Strukturë” është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve (ECTS). Kohëzgjatja e këtij program studimi është 2 (dy) vjet me simetra 2 semestra secili në total 120 kredite bazuar në plotësimin e nevojave të studntëve që ndjekin këtë program studimi. 1 (një) kredit është i barazvlefshëm me 25 orë gjithsej, ku përfshihen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, laboratore) dhe punë individuale e studentit sipas VKM Nr.41/2018 (i ndryshuar) dhe Rregullores së departamentit. Mbyllja e studimeve kërkon marrjen e diplomës, e cila shlyhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës me tematikë të përcaktuar më parë. Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Master i Shkencës në Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturë, është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS. Bazuar në Rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale qëduhet kryer nga studentit për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Referenca: Aneks 6, Rregullore e Programit; Aneksi 40, Plan programi dhe Veprimtaritë formuese të Programit; Aneksi 30, Tabela 14, Model Syllabusi; Aneks 18, Model Diplome dhe Suplementi.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për</p>	<p>Bazuar në planin mësimor, programi i studimit Master i Shkencës “Inxhinieri Ndërtimi” profili “Strukturë” është i ndarë në tre pjesë (Thellim i formimit të përgjithshëm- 4 lëndë, Formim i kulturës inxhinierike – 3 lëndë dhe Formim i thelluar në profesion – 11 lëndë) me synimin t’u japë studentëve formimin e shprehive nëpërmjet sejcilës lëndë apo modul, plotësimin e që t’u sigurojë atyre formimin profesional për një gamë më të gjerë specialitetesh në drejtime të ndryshme pune si në projektim, zbatim të punimeve dhe menaxhim të punimeve të ndërtimit. Aftësitë shprehimore teknike i lejojnë studentëve për t’u përballur specializime edhe më të ngushta në këtë fushë studimi, për të marrë kompetenca dhe të ushtrojnë profesionin e tyre me përgjegjësi dhe vazhduar studimet e thelluara edhe në ciklin e tretë të studimeve. Të</p>

<p>zgjdhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetenca të nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike apo zgjidhjen e problemeve më të vështira teknike e profesionale. Programi i studimit të ciklit të dytë ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve me njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe praktike në Inxhinierinë e Ndërtimit, profili "Strukturë". Ky program është hartuar bazuar në studimin e kryer për nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit. Duke vlerësuar dosjen e këtij programi studimi si dhe bazuar në takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL dhe komunikimit me pedagogët e lëndëve të këtij program dhe studentët, GVJ konstaton se Programi i studimit të ciklit të dytë ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve me njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe praktike në "Inxhinieri Ndërtimi", profili "Strukturë". Ky program është hartuar bazuar në studimin e kryer për nevojat e tregut të punës dhe në përshtatje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p>Referencë: Aneksi 40, Plani mësimor; Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij; Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se ky program studimi është hartuar duke marrë në konsideratë elementët e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe duke u shprehur në planin mësimor dhe programet mësimore të lëndëve të këtij programi studimi. Programi i studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi, profili "Strukturë" përmban elementët e nevojshëm që lejojnë krijimin e strukturës së tij. Programi është licensuar me 120 ECTS. Një kredit është 25 orë mësimore. Një vit akademik është me 60 ECTS, të cilat janë të barabarta me 1500 orë mësimore në total. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të prgjithshëm të 1500 orëve. Programi i studimit ka të përcaktuara qartë detyrimet përmbyllëse të programit; ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale me 9 kredite/180 orë (punë individuale, në kompani dhe takime me mbikqyrësin) me kohëzgjatje 12 javë mësimore. Teza dhe Project Diploma vlerësohet me 18 kredite (ECTS) përfshirë dhe mbrojtjen përfundimtare të Projektit të Diplomës. Të gjitha veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit si orët në auditor, ato jashtë auditori për studim individual, përgatitja për provime, përgatitja e tezës së diplomës etj., janë të përcaktuara sipas rregulloreve përkatëse dhe sipas planit mësimor.</p> <p>Referenca: Aneks 7, Rregullore e Programit të Diplomës; Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet në këtë program studimi</p>

<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet në këtë program studimi</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Organizimi i studimeve të këtij program studimi është në përputhje të plotë me VKM Nr.41, datë 24.01.2018, (i ndryshuar) referuar elementëve përbërës të programeve të studimit për secilin cikël të studimit, tipeve të komponentëve dhe programit të lëndëve. Pranimi i studentëve bëhet me një Testim pranimi. Kandidatët fitues në konkurs rregjistrohen brenda afateve të shpallura. Studenti që fiton statusin e studentit ka të drejtë të ndjekin studimet në proramet e rregjistruara. Në varësi të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Udhëzimeve të veçanta të MAS, që kanë të bëjnë me kriteret e pranimeve ku mesatarja e pranimeve ka ndryshuar, e cila është subjekt i rishikimit sipas urdhërit të MASR dhe Testit të Pranimit (<i>i cili çdo vit rishikohet nga fakulteti përkatës</i>), është Universiteti Polis Ai që llogarit, vlerëson dhe përditëson koston e studimit. GVJ konstaton se në këtë kosto janë të përfshira të gjitha zërat më të rëndësishëm. Referenca: (Aneksi 3, neni 16, Rregullore e përgjithshme)</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Inxhinieri Ndërtimi, profili “Strukturë” është program Master Shkencor (cikli i dytë) dhe ofrohet në të njëjtën fushë studimi dhe ka përmbajtje të ngjashme në nivel së paku 70% me programe të institucioneve të tjera me të njëjtin emërtesë. Nga takimi me stafin e këtij program na u konfirmua një gjë e tillë. Me përfundimin e studimeve studentët pajisen me Diplomë, e cila Ju mundëson të pajisen me licensë profesionale si Inxhinier Strukturist nga Ministria përkatëse.</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Program i studimit është i shoqëruar me kodin përkatës në “Inxhinieri Ndërtimi” 72MS referuar Fushës së studimit -KSNA-F 2013 dhe kodifikimit të lëndëve që përbëjnë këtë program studimi. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Në kategorinë A bëjnë pjesë 3 lëndë (9 kredite), në kategorinë B bëjnë pjesë 11 lëndë (63 kredite), në kategorinë C bëjnë pjesë 3 lëndë (18 kredite), në kategorinë D bëjnë pjesë 2 lëndë (12 kredite), në kategorinë E bëjnë pjesë 1 lëndë (18 kredite). Bazuar në tabelën Nr.9, viti akademik 2023-2024, kreditet përkatëse të lëndëve sipas kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje, e shprehur në përqindje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A- 8%, prej (5-10%) • Kategoria B- 53%, prej (50-60%) • Kategoria C- 15%, prej (12-20%) • Kategoria D- 10%, prej (10.00%) • Kategoria E- 15%, prej (10-15%) <p>Bazuar në (VKM 879, date 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.</p>

	Referenca: Kurrikula e programit të studimit; Tabela 9. Plani mësimorë i ndarë sipas veprimtarive Formuese (A-E); Shënime nga vizita në Institucion.			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk aplikohet në këtë program studimi			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Program i studimit është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve (ECTS). Plan i mësimorë realizon thellim në formimin e përgjithshëm, kulturor inxhinierik dhe të thelluar në profesion në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit është i shoqëruar me kodin përkatës në "Inxhinieri Ndërtimi" 72MS referuar fushës së studimit -KSNA-F 2013 dhe kodifikimit të lëndëve përmbushin kërkesat ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Strukturë akademike e Fakultetit është e ndarë në departamente, me Personel akademik efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontratë (PAK) dhe Personeli Administrativ. Njësitë kryesore të Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajn janë: Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Departamenti i Art-Dizajn dhe Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri, Dizajn. Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi në Profilin "Strukturë" ofrohet nën përgjegjësinë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë me dekan Dr. L. B, i cili koordinon veprimtaritë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore. Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajn (FAD) është njësia kryesore që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor. Sipas informacionit të marrë, Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë ka 1(një) Prof. Asoc.Dr, 10 (dhjetë) Dr; 5 (pesë) Dr. proc dhe 5 (pesë) MSc, duke plotësuar njëkohësisht edhe detyrimin ligjor për numurin minimal prej 6 (gjashtë) pedagogësh me tituj e grada shkencore. Të drejtat dhe përgjegjësitë e çdo njësie janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit. Departamenti i "Arkitekturës dhe Inxhinierisë" për vitin akademik 2023-2024 me shkresë Nr 741/ 23 datë 09.10.2023 ka kërkuar mos aktivizimin e profilit "Gjeoteknikë" pasi nuk ka patur studentë të regjistruar për 2 vitet e fundit dhe kërkesa për

	<p>akreditim është bërë vetëm për profilin “Strukturë”. Ky vendim është miratuar edhe me vendim senati nr. 26, datë 06.10.2023. GVJ gjatë vizitës në institucion është përqëndruar në vlerësimin vetëm të programit për profilin e studimeve “ Strukturë”.</p> <p>Referenca: Raporti GVB; Shënime nga vizita në Institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Bazuar në vendimin Datë 15.02.2023, dekani i Fakultetit të “Arkitekturë e Dizajn” Dr. Prof. Asoc. L. B ka angazhuar personel akademik Dr. O. S efektiv për realizimin e praktikave mësimore /labororët dhe monitorimin e këtij procesi deri në finalizimin e studimeve për studentët e këtij cikli studimesh. Detyrat e njësisë bazë dhe të drejtuesit të departamentit janë të përfshira në statutin dhe Rregulloren e përgjithëshme të Universitetit POLIS si edhe në aktet e tjera e rregullore të departamentit edhe për këtë program studimi. Referenca: Raport i GVB</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Një rol të rëndësishëm për realizimin e këtij program luan stafi administrativ, i cili, me anë të mekanizmit të formularëve të vlerësimit të studentëve, që plotësohen në mënyrë anonime prej tyre ndikon në cilësinë e programit të studimit të Inxhinierisë së ndërtimit Aneks, Pyetsor për vlerësimin). Stafi akademik i Fakultetit dhe ai i Universitetit, gjithashtu aktivizohen në aktivitetet administrative, respektivisht dhe në varësi edhe të ngarkesës mësimore akademike që ata kanë. Stafi angazhohet për lehtësimin e realizimit të praktikave mësimore dhe në aktivitetet shkencore të studentëve në përputhje me objektivat e tij. Referuar Vendimit e Këshillit të Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajn si dhe takimeve gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Dr. E. D, për vitin 2023-2024; pjesë e stafit akademik në këtë njësi është caktuar koordinator për programin Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi-profilu Strukturë. Koordinatori është pjesë e stafit me kohë të plotë dhe përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit mësimorë dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e vendosura për programin e studimit; ky fakt na u konfirmua edhe nga takimi me stafin mësimorë në datën 17.01.2024. Ai organizon takime me stafin e programit të studimit dhe raporton tek drejtuesi i departamentit për plotësimin e objektivave dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me këtë program studimi.</p> <p>Referenca: Raporti i GVB; Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson programi Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi në Profilin “Strukturë” ofrohet nën përgjegjësinë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, si njësi bazë, duke plotësuar njëkohësisht edhe detyrimin ligjor për numurin minimal prej 6 (gjashtë) pedagogësh me tituj e grada shkencore në programin e studimit “Strukturë”. Të drejtat dhe përgjegjësitë e çdo njësie janë të përcaktuara në aktet rregullore të institucionit, me Vendimet e Këshillit të Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajn. Gjatë vizitës, GVJ konstaton se Dr. Endri Duro, për vitin 2023-2024; pjesë e stafit akademik në këtë njësi është caktuar koordinator për programin Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi-profilu Strukturë, pjesë e stafit me kohë të plotë; i cili përgjigjet për ecurinë dhe zhvillimin e programit mësimorë e praktikave profesionale në përputhje me objektivat e vendosura për programin e studimit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Universiteti POLIS, si njësi kryesore, ofron informacionin e nevojshëm për të gjithë studentët dhe stafin mësimorë akademik. Ky informacion ka bërë me si me programet mësimore ashtu dhe me të gjithë elementët e tyre. Në programin e studimit që ofron njësia bazë (tabela 4), janë të përcaktuara emërtimi i lëndëve, kreditet përkatëse, sasia e orëve mësimore në auditor dhe ato të punës individuale të studentit, titullarët e lëndëve dhe elementët e tjera të programit të çdo lëndë. Referenca: Tabela 4 (Ngarkesa totale e personelit akademik të Programit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi); tabela 6.3(Stafi akademik viti 2023-2024)
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Sipas “Rregullores Didaktike”, Aneksi 4, Programi i Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, përmban 14 lëndë të organizuara në 21 module, ku janë të përfshira dhe një intership profesional dhe teza e diplomës. Lëndët si pjesë e këtij program studimi, përmbajnë: qëllimin, objektivat, elementët e kontrollit të dijeve, tematikat e leksioneve dhe seminarëve, literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar përfshirë dhe të dhëna që lidhen me numrin e krediteve, sasinë e orëve në auditor dhe individuale të studimit, emrin e titullarit dhe vitin dhe semestrin kur zhvillohet lënda. Programi i studimit (vit, semestral, javë) është i organizuar në 2 (dy) semestra, me këtë përmbajtje: 1 vit akademik me 30 javë mësimore në auditor; 1 semestër me 15 javë mësimore në auditor; 1 ECTS konvertuar me 25 orë mësimore punë të studentit; Ora mësimore është 50 minuta. Ndërsa kreditet përbëhen si vijon: Leksionet dhe Seminarët 8-12 orë në auditor dhe 13-17 orë punë e pavarur; Ushtrime/ Studio/Wshp 8-12 orë në auditor dhe 13-15orë punë e pavarur e studentit; Praktikat e lëndëve janë të përfshira në orët e Studio/ Ushtrime/ Wshp; Praktika profesioinale 20 orë në auditor dhe 5 orë punë e pavarur e studentit; Teza e Projekt diploma 8 orë në auditor dhe 7 orë punë e pavarur e studentit si dhe Studio/ Ushtrime/ Wshp 10 orë në auditor dhe 15 orë pune e pavarur student.Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti akademik për 1(një) student me kohë të plotë është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ECTS ose 1500 (njëmijëepesëqind) orë pune mësimore të studentit në auditor dhe punë e pavarur e tij. Referenca: Aneksi 4, Program. i Studimit në Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të	Universiteti POLIS, ka një infrastrukturë shumë të mirë të sistemit të informimit të studentëve, i cili iu vjen në ndihmë studentëve në rrugë të ndryshme siç janë vendosja në mjedise të brendshme të universitetit e tabelave ku gjinden fisha informimi për programin e studimit, rregullore e programit të tij, botime në trajtë fletë palosje, ku janë të përfshira qartë

<p>pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>këto informacione. Pas konsultimit të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se programi i studimit Master Shkencor në "Inxhinieri Ndërtimi" përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Kriteret e pranimit që duhet të përmbushin studentët, janë të përcaktuara në Rregulloren Didaktike të këtij programi (Aneksi 4, Kreu IV); përfshirë edhe kriteret për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve ndërmjet të të njëjtit cikël si brenda U POLIS apo nga institucione të tjera.</p> <p>Referenca: Aneksi 4, Kreu IV i Rregullore didaktike; Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Stafi akademik luan një rol të rëndësishëm sa i përket sigurimit të informacioneve për studentët për përmbajtjet e lëndëve të detyrueshme ose me zgjedhje për çdo semestër. Njëri nga pedagogët e hartimit të programit është edhe këshilltari i studentit për të regjistruar e përzgjedhur lëndët në çdo semestër. Gjatë këtyre takimeve studentëve u bëhet e qartë se cilat janë elementët kryesorë dhe procedurat që duhen respektuar në proceset akademike si p.sh. ngarkesa e punës në auditor, frekuentimi apo ndjekja e programit dhe specifikat për secilën lëndë, cilat janë përbërësit e tjerë të programit si praktikat, ushtrimet, orët laboratorike etj.</p> <p>Referenca: Aneks 30, tabela 14, Format Syllabusi; Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Departamenti çdo vit ka patur në vëmendje të tij përditësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Në mbledhjet e departamentit janë diskutuar përmbajtja e programeve të studimit, problemet që kanë dalë në çdo vit akademik si edhe të rehat më të fundit në fushat përkatëse. Programi i studimit mund të pësojë ndryshime deri në masën 20% të përmbajtjes së programit, këto ndryshime të shprehura në kredite ECTS miratohen nga Senati Akademik i Universitetit POLIS. Këto ndryshime në përmbajtjen e programit të studimit janë reflektime, përmirësime dhe përditësimet të vazhdueshme të programit përkundrejt nevojave të tregut. Njësia bazë është në kontakt të vazhdueshëm me të diplomuarit e programit ashtu edhe me bizneset nëpërmjet organizimit të tryezave të rrumbullakëta apo mbajtjes së leksioneve të hapura në auditor.</p> <p>Referenca: Tabela 11 (Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licensuara, viti akademik 2023-2024); Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriteve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Programi i studimit është i detajuar, është informues, është i strukturuar dhe i organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. Si njësi kryesore, Universiteti POLIS, ofron informacionin e nevojshëm për të gjithë studentët dhe stafin mësimorë akademik si për programet mësimore ashtu dhe me të gjithë elementët përbërës të tyre. Programi i studimit është i organizuar në 2 (dy) vite akademike, secili me 30 javë mësimore në auditor; 1 ECTS konvertuar me 25 orë mësimore punë të studentit; Ora mësimore është 50 minuta. Praktikët e lëndëve janë të përfshira në orët e Studio/ Ushtrime/ Wshp, ndërsa Praktika profesionale 20 orë në auditor dhe 5 orë punë e pavaur e studentit, Tëza e Projekt diploma 8 orë në</i></p>

	auditor dhe 7 orë punë e pavarur e studentit si dhe Studio/Ushtrime/Wshp 10 orë në auditor dhe 15 orë pune e pavarur student.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Strukturë dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Hartimi i këtij programi studimi është bërë duke marrë parasysh faktin që, përmbajtja e tij të jetë në përputhje me qëllimin/ objektivat e programit, me kriteret dhe detyrimet për këtë program në nivelin master i shkencave në përputhje me aktet ligjore të përcaktuara nga korniza Shqiptare dhe ajo Evropiane si dhe akteve të brendshme rregullatore të Universitetit POLIS për arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxënit dhe kërkimit. Fakulteti dhe Departamenti kanë kryer edhe studime tregu që për këtë program, duke u interesuar për studentët që mbarojnë edhe për orientimin në tregun e punës Pavarësisht analizës së tregut, studimi shoqërohet edhe me vëzhgime periodike të ndryshimeve të kërkes/ ofertës ato janë bazuar në nevojat që kanë sektori publik dhe ai privat për burime njerëzore në shtete të ndryshme të BE. Referuar lëndëve mësimore, programi i studimit ka treguar se arrin të përmbush objektivat formuese të programit studimor me rezultatet të kënaqëshme të të nxënit, mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Referenca: Aneksi 11, Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi.
Kriteri 2. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	GVJ është i mendimit se program i studimeve, përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve mundësojnë njohuri, aftësi dhe punësim të studentëve. Strukturë e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe i përafëruar edhe me programe të ngjashme të universiteteve partnere dhe eksperiencat ndërkombtare. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregulloren e këtij programi. Referenca: Aneksi 6, Rregullore e Programit; Shënime nga vizita në Institucion
Kriteri 3. Strukturë e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi,	Departamenti përgjegjës i këtij programi, kryen analizë vjetore për të parë nëse janë arritur objektivat e programit si dhe rezultateve të pritshme të nxënit dhe aftësimin profesional për studentët. Programi i studimit është hartuar duke mbajtura parasysh përcaktimet në lidhje me strukturën e programit të studimit sipas kriterëve të vendosura nga VKM 41 në përputhje me Planin e Zhvillimit të Universitetit POLIS, vizionin dhe misionin e tij, nevojat e tregut të punës, misionin e arsimit të lartë në vend. Në rregulloren e programit të studimit janë të përcaktuara raportet e formimit teori-praktikë të formimit profesional të studentëve në plotësim

kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	të objektivave në tërësi të programit. Referenca: Rregullore e programit të studimit; Shënime nga vizita në Institucion
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Syllabuset e lëndëve në programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" në profilin "Strukturë" parashikojnë kontrollin e dijeve të ndara në: pjesëmarrje aktive në auditor, detyra përgjatë semestrit, provimin e pjesshëm dhe provimin përfundimtar. Konceptimi dhe ndarja mes veprimtarive formuese synon që studentët të kenë mundësi mobiliteti dhe transferimi studimesh, të konkurojnë dhe të përshtaten denjësisht jo vetëm në kushtet e tregut vendas, por edhe më gjerë, siç përcaktohet edhe në dokumentat e hartuar nga U POLIS. Referenca: Aneks 30, tabela 14, Format Syllabusi.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Stafi akademik është përgjegjës për zhvillimin e lëndëve në këtë program studimi dhe për rrjedhojë ai përditëson çdo vit programet e lëndëve (syllabuset), duke mundësuar literaturën bazë dhe atë ndihmëse të viteve më të fundit për përfitimin e dijeve. Në secilin prej syllabuseve janë pasqyruar edhe rekomandime nga sektori i ndërtimit. GVJ në takimin me studentët, u informua se ka patur raste që përmbajtja e programit apo edhe literatura janë përmirësuar nga sugjerimet e shoqatës e ALUMNI e studentëve të diplomuar. Referenca: Aneks 30, tabela 14, Format Syllabusi.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Në syllabuset e lëndëve janë të reflektuara pjesa përmbledhëse dhe rezultatet e përfitimit të dijeve, përshkruhet dhe objektivi, synimet dhe kompetencat që studentët përfitojnë me mbarimin e studimeve. Në këtë program studimi është mbajtur parasysh që të ketë një raport optimal ndërmjet pjesës teorike dhe trajtimeve praktike, kryesisht të praktikave mësimore. Gjithashtu, në rregulloren e programit të studimit është e përcaktuar që përmbajtja e lëndëve dhe moduleve duhet të garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara tek studentët. Referenca: Aneks 30, tabela 14, Format Syllabusi; Shënime nga vizita në Institucion
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit në Inxhinieri Ndërtimi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë që kërkohen në këtë fushë. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë tek studentët një bazë shumë të mirë edhe për kërkim shkencor, të nevojshme për ciklin e tretë të studimeve në doktoraturë dhe punësim e integrim të shpejtë me kërkesat që shtrou tregu i punës. GVJ vlerëson që, përmbajtja e programit të studimit dhe niveli i përgatitjes ka krijuar kushte dhe mundësi edhe për ecurinë e mëtejshme në fusha e tjera të inxhinierisë së ndërtimit, të lidhura ngushtësisht edhe me nevojat e tregut të punës në ndërtim siç është Vlerësimi i Pasurive të Paluajtshme, etj. Referenca: Përmbajtja e Programit të studimeve; Shënime nga vizita në Institucion
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson se përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me qëllimin, objektivat, kriteret dhe detyrimet në nivelin master i shkencave të parapara edhe në aktet ligjore Shqiptare dhe ato Evropiane; përfshirë dhe aktet e brendshme të Universitetit POLIS. Programi i studimeve, përmbajtja e tij, veprimtaritë dhe shpërndarja e lëndëve mundësojnë njohuri, aftësi dhe punësim të studentëve. Strukturë e</i>

	<i>programit, lëndët, raporti teori/praktikë përputhet edhe me profilin e programit të studimit të ngjashme me ato ndërkombëtare. Përditësimi i programeve të lëndëve (syllabuset), ka mundësuar literaturën bazë më të fundit, pasqyruar edhe rekomandime nga sektori i ndërtimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Zhvillimet e reja kanë shtruar nevojën dhe përshtatjen e kurrikulave mësimore me kërkesat e tregut të punës, për rrjedhojë edhe kryerjen e ndryshimeve në kurrikula apo në përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit. GVJ, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në institucion konstaton se departamenti i Arkitekturës dhe i Inxhinierisë së ndërtimit për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit konsultohet dhe merr në konsideratë propozime nga bashkëpunorë dhe partnerë të interesuar në tregun e punës. Studentët janë pjesë e rëndësishme e procesit për përmirësimin e programit të studimit dhe përfaqësues në organet më të larta drejtuese të Universitetit POLIS si Senati akademik dhe Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë me të drejtë vendim marrje. Në konsultat e organizuara marrin pjesë jo vetëm studentët që ndjekin studimet, por edhe studentë që kanë kryer studimet; të cilëve ju krijohen mundësitë të përfitojnë mbi tematikat e diskutuara por, edhe të sugjerojnë propozime për ndryshime të kurrikulave. Institucioni e ka kthyer në normë që të përfshijë dhe aktivizojë studentët për të shprehur mendimet në përmirësimet e vazhdueshme të programit të studimit. Njësia bazë (dekanati) për vlerësimet e kryera merr dhe aprovimin e tyre në Senatin Akademik. Referenca: https://universitetipolis.edu.al/wpcontent/uploads/2023/02/042_Students_Council_Members.pdf ; Shënime nga vizita në Institucion
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe Strukturët e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Studentët janë pjesë e rëndësishme e procesit për përmirësimin e programit të studimit dhe përfaqësues në organet më të larta drejtuese të Universitetit POLIS si Senati akademik dhe Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë me të drejtë vendim marrje. Në konsultat e organizuara marrin pjesë jo vetëm studentët që ndjekin studimet, por edhe studentë që kanë kryer studimet të cilëve ju krijohen mundësitë të përfitojnë mbi tematikat e diskutuara por, edhe të sugjerojnë propozime për ndryshime të kurrikulave. Institucioni e ka kthyer në normë që të përfshijë dhe aktivizojë studentët për të shprehur mendimet në përmirësimet e vazhdueshme të programit të studimit. Njësia bazë (dekanati) për vlerësimet e kryera merr dhe aprovimin e tyre në Senatin Akademik. Referenca: https://universitetipolis.edu.al

	/wpcontent/uploads/2023/02/042_Students_Council_Members.pdf: Shënime nga vizita në Institucion			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Referuar (RVB) si dhe takimeve të kryera gjatë vizitës në institucion me Dekanin e “Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajn” njësia përmirëson, përditëson apo edhe përshtat programin e studimit “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil “Strukturë” me propozimet e zhvillimet më të fundit në fusha të Inxhinierisë së Ndërtimit. Bashkëpunimet me partnerë, rrjete dhe organizma të ndryshëm, siç janë Instituti Co-PLAN, pranë universitetit dhe Studio e Arkitekturës e Inxhinierisë MetroPOLIS kanë pasuruar përvojën e stafit dhe intershipet e studentëve në projekte konkrete, një hallkë e rëndësishme për thithjen e informacionit të nevojave të profesionit dhe tregut. Në këtë aspekt janë të rëndësishme dhe bashkëpunimet ndërinstituconale me studio projektimi e zbatimi, administratën publike e bashki, universitete etj., Akademinë e Shkencave, Arkivën e Ndërtimit Teknik Qendror, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjensia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Bashkitë e Tiranës, Durrësit, Korçës, Sarandës, Dropullit etj. Referenca: Aneksi 30, Tabela 5, Lista e institucioneve dhe organizatave bashkëpunuese; Shënime nga vizita në Institucion			
Konkluzione	<i>GVJ, gjatë vizitës në institucion konstaton se departamenti i Arkitekturës dhe i Inxhinierisë së ndërtimit për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit konsultohet dhe merr në konsideratë propozime nga bashkëpunorë dhe partnerë të interesuar në tregun e punës. Studentët janë pjesë e rëndësishme e procesit për përmirësimin e programit të studimit duke u përfaqësuar deri në organet më të larta drejtuese të Universitetit POLIS si Senati akademik, departamenti (përkatës duke i përfshirë në përmirësimet e kurrikulave të studimit) apo aktivizimi në Njësinë e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë me të drejtë vendim marrje. Bashkëpunimet me partnerë, siç është Instituti Co-PLAN, pranë universitetit dhe Studio e Arkitekturës e Inxhinierisë MetroPOLIS kanë pasuruar përvojën e stafit dhe intershipet e studentëve në projekte konkrete edhe me Akademinë e Shkencave, Arkivën e Ndërtimit Teknik Qendror, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjensia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Bashkitë e Tiranës, Durrësit, Korçës, Sarandës, Dropullit si një hallkë e rëndësishme për thithjen e informacionit të nevojave të profesionit dhe tregut.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit	GVJ nga shqyrtimi i dokumentave strategjike të Universitetit POLIS, (Statuti, Strategjia e Zhvillimit, Rregullore e Fakultetit dhe Departamentit etj) si dhe nga vizita në institucion, vlerëson se programi i studimit Master

dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	i Shkencës në "Inxhinieri Ndërtimi", profili i studimeve "Strukturë" është në përputhje e në zbatim të planit strategjik dhe objektiveve madhorë të institucionit, në kuadër të strategjisë afatgjatë të zhvillimit të Universitetit POLIS në procesin e mësimdhënies/ mësimnxënies, kërkimin shkencor, bashkëpunimin kombëtar e ndërkombëtar, studentët, etj. Referenca: "Statuti i UPOLIS" 2017; Aneksi 12. Strategjia e Zhvillimit të UPOLIS 2021-2026. Rregullore e FAD; Rregullore e Departamentit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë; Shënime nga vizita në Institucion
Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn menaxhon, bashkërendon e administron veprimtaritë e mësimdhënies me ato kërkimore. Gjatë takimit me stafin akademik, por edhe nga shqyrtimi i dosjeve të tyre, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, aplikon instrumenta nxitës të tillë si fondi i vënë në dispozicion nga IAL për kërkimin shkencor, mundësi për publikimin e artikujve dhe materialeve shkencore në revistën shkencore, pjesëmarrje në konferenca shkencore etj., duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. Autonomia dhe liria akademike janë garantuara dhe ato bazohen në të drejtën ligjore si dhe në Statutin e U POLIS dhe Rregulloren e Përgjithshme të tij. Në nivel departamenti çdo vit hartohet plani vjetor i kërkimit shkencor, i cili parashikon edhe shpenzimet financiare të kërkuara. Plani miratohet nga dekanati i FAD. Referenca: "Statuti i UPOLIS" 2017, Rregullore e Pwrgjithshme e U POLIS. Aneks 24, Procedura e mbështetjes financiare për stafin akademik, Aneksi 26, Politika e mbështetjes së stafit në kërkimin shkencorë; Shënime nga vizita në Institucion
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Referuar dokumentacionit të konsultuar si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime e shkëmbime dhe projekte ndërkombëtare, duke i krijuar mundësi që ata të bëhen pjesë e grupeve të kërkimit. Ndër këto angazhime me interes janë Laboratori "IF- Innovation Factory" në përbërje të U POLIS si dhe një nga inisiativat më të fundit ku studentët mund të zhvillojnë idetë për projektet e tyre siç është dhe Tirana "First Incubation Programme", në të cilin realizohet dhe pjesëmarrja e studentëve ndaj çështjeve të inovacionit për sejcilin fakultet. Vlen të përmenden Workshope me pjesëmarrje të stafit akademik dhe studentëve gjatë vitit akademik 2022-2023: 1. Workshop; Tirana Architecture Weeks-WS10 (viti akademik 2022-2023); 2. Kurs nga Ph.D. Elisabete Teixeira, E. Duro, F. Krosi, me temë: Urban Critical Infrastructure Risk Evaluation; 3. A. Balilaj, E. Beqiraj, E. Duka, E. Doci, F. Kaziaj, L. Musaj: "Urban-Critical Infrastructure Risk Evaluation". 4. M. Bufi, S. Shehu, Xh. Molla, A. Kastrati, S. Qorri dhe J. Kotarja: "Urban-Critical Infrastructure Risk Evaluation". 5. B. Lami, G. Balla, H. Shehaj, I. Karaboja, N. Fana dhe S. Sedini "Urban-Critical Infrastructure Risk Evaluation" Referencë: Evidencë 1(WorkshoPET e organizuara) https://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/55 ; Shënime nga vizita në Institucion

<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të konsultuar si dhe vizitës në institucion gjatë takimeve me stafin akademik si dhe drejtues të Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë dhe Projektet, GVJ konstaton se U POLIS mbështet njësinë kryesore dhe atë bazë për të zhvilluar kërkimin shkencor. Institucioni ka mbështetur stafin akademik të njërive kryesore të Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajn (FAD) me burimet e brendshme të tij por edhe me contribute nga projektet e përbashkëta të finacuara nga Qeveria Amerikane, Italiane, Hollandeze dhe Austriake qoftë drejtpërdrejt me U POLIS apo edhe nëpërmjet bashkëpunimeve me Partnerin Strategjik COPLAN në publikimet e tyre falas në revistën shkencore të institucionit; Pjesëmarrjen falas në konferencat e organizuara prej institucionit ose në bashkëpunim me insitucione të tjera; sponsorizimin e artikujve shkencorë të publikuar në revista apo konferenca shkencore; Sponsorizimin e publikimit të literaturave studimore, etj.</p> <p>Referenca: "Statuti i UPOLIS" 2017, Rregullore e Përgjithshme e U POLIS, Aneks 24, Procedura e mbështetjes financiare për stafin akademik, Aneksi 26, Politika e mbështetjes së stafit në kërkimin shkencorë; Shënime nga vizita në Institucion</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmblendhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime e shkëmbime dhe projekte kombëtare e ndërkombëtare, duke krijuar mundësi që ata të jenë pjesë e grupeve të kërkimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi II.7 Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me Strukturë të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se në fillim të çdo viti institucioni miraton grupet lëndore dhe ato të kërkimit shkencor, të bashkëpunimit me Strukturë të tjera cilat lidhen dhe me aplikimet për projekte. Organizimi, i tyre bëhet në grupe sipas tematikave/ projekteve të ndryshme dhe partneritete në nivel local, rajonal dhe global. Objektivat përzgjidhen të tilla ku trajtohen çështje të mëdha sociale, ekonomike dhe problematika themelore në fushën e inxhinierisë së ndërtimit.</p> <p>Referenca: Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë në studime e projekte me karakter kërkimor e shkencor përveç stafit akademik angazhon edhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. Studentët njihen nga afër me fushat e kërkimit shkencorë në inxhinierinë e ndërtimit duke rritur nivelin e tyre të arsytimit e krijimit të mendimit shkencor, që i shërben më vonë për punimin e temave të diplomës. Rezultatet e këtij aktiviteti gjenden edhe në linkun. <i>Habitat 9-Polis_Press (universitetipolis.edu.al)</i></p>

<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Departamenti ka marrë pjesë dhe ka organizuar edhe projekte të tjera ku studentë të ndryshëm janë angazhuar dhe kanë punuar mbi produkte reale. Ndër këto vlen të përmendet Bashkëpunimi ndërkombëtar i departamentit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë në Universitetin POLIS me Rrjetin e Shkollave Evropiane të Inxhinierisë së Ndërtimit për trajnim dhe edukim EUCEET (European Civil Engineering Education and Training Association). Në vitin 2021 Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit ka marrë pjesë në Konferencën e përbashkët të EUCEET dhe AECEF mbi “Roli I edukimit të Inxhinierit për implementimin e SDGs”. Përvoja e fituar i ka shërbyer stafit për të forcuar bashkëpunimin edhe për kurrikula, lëndë, modele të implementimit të objektivave aktuale, përvojave në mësimdhënie për module dhe lëndë specifike si dhe shkëmbimit të eksperiencave në fushën sizmike. Bashkëpunime dhe njohje, departamenti i Inxhinierisë ka patur dhe me përvoja të tjera si Japoneze, Zelandeze ashtu dhe me ato rajonale mbi reziliencën dhe përbalimin e situatatës post tërmet, njohja me literaturë më të gjerë dhe me standarde ndërtimi, shfrytëzimi dhe riparimi të Strukturëve të dëmtuara.</p> <p>Referenca: Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacioni i dorëzuar vëren se Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi përmbush kërkesat për kompetencë, rezultatet e të nxënit, aftësimin e studentëve për të demonstruar aftësi në interpretimin e situatave të ndryshme inxhinierike për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut kombëtar e ndërkombëtar të punës dhe të metodologjisë së studimit e kërkimit, në zgjidhjen e problemeve inxhinierike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit ndërtues.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi-profilin “Strukturë”, i përmbush kërkesat e këtij kriteri. Me diplomën e fituar, studentët dëshmojnë kompetencë edhe për t’u pajisur me licensën respektive të Inxhinierit Strukturist nga Institucionet e linjës dhe aktet ligjore të fushës për të cilat kanë kryer studimet, sepse programi i studimit përputhet me kërkesat e fushave të lincensimit.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit përmbush kërkesat e këtij kriteri pasi është në përputhje me aktet ligjore në vend referuar Nivelit të dytë sipas Kornizës Shqiptare të Kodifikimit dhe fushës 72MS, sipas fushës ku bën pjesë program KSNA-F2013 si dhe kuadrit Evropian të Kualifikimeve, Nivelit 7-të të tij duke evidentuar në çdo modul përmbledhjen, rezultatet e të nxënit, njohuri të që përfitohen, aftësitë dhe kompetencat</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ, vlerëson se Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor për studentët dhe atafin akademik. Çdo vit me fillimin e vitit akademik departamenti miraton grupet lëndore dhe ato të kërkimit shkencor e të bashkëpunimit me Strukturë të tjera për aplikimet në projekte, në grupe sipas tematikave të ndryshme dhe partneritetet në nivel local, rajonal dhe global. Objektivat e</p>

	<i>përzgjedhura trajtojnë çështje sociale, ekonomike dhe problematika themelore në fushën e inxhinierisë së ndërtimit. Rezultatet e këtyre aktiviteteve gjenden edhe në linkun Habitat 9-Polis_Press (universitetipolis.edu.al).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë vlerëson si shumë të rëndësishëm cilësinë e programeve të studimit, për pasojë ofrimin e formave sa më efektive me qëllimin kryesorë për të përgatitur specialist me cilësitë e kërkuara nga tregu i punës. GVJ gjatë vizitës vlerësuese u njoh me metodat e mësimdhënies për këtë program studimi dhe elementët përbërës të tij, të parashikuara edhe në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit si: leksione direkte, leksione të hapura, seminare, ushtrime, laboratore, praktika mësimore e profesionale, vizita në kantjere, ekspozita, panaire, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj. Personeli akademik respekton dhe i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike duke u mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Ëorkshopet kanë qenë një nga metodat e mësimdhënies, tashmë të kthyera në traditë në U. POLIS, të organizuar gjatë viteve akademike siç janë 21 ëorkshopet, që gjithkush mund t'i gjejë shumë lehtë në listën në këto dy adresa në enternet siç janë: Tirana architecture week https://tiranaarchitectureweek.com dhe Tirana design week https://tiranadesignweek.com. Referenca: Aneksi 6, Rregullore e programit të studimit; tabela përmbledhëse</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Mësimdhënia në Universitetin POLIS rezulton të jetë e larmishme, në varësi të specifikave të lëndëve dhe nevojave të studentëve. Ofrohen mundësi të barabarta për të gjithë studentët, pavarësisht nivelit të përgatitjes së tyre. Format e mësimdhënies mbajnë parasysht rezultatet e vlerësimeve të ndryshme, të kryera sipas programit të studimit. Konsultat individuale të pedagogëve për detyrat/ projektet me studentët kanë krijuar një mjedis të bashkëpunues dhe ndihmues për ngritjen e cilësisë dhe kultivimin e besueshmërisë individuale tek studentët. GVJ, gjatë vizitave dhe takimeve me studentët konstatoi se midis stafit akademik dhe studentëve janë vendosur raporte inkurajuese si gjatë kontrolleve periodike ashtu dhe gjatë vlerësimit të tyre me mbylljen e procesit mësimorë akademik. Nga na tjetër, ky process i ka shërbyer edhe vetë pedagogëve për të rritur efektivitetin në kombinimin e metodave të mësimdhënies. Referenca: Minuta të takimit me studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në</p>	<p>Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik</p>

<p>përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe ëorkshope me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme. Nga ana tjetër, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit ofron metoda pedagogjike shumë të larmishme dhe fleksibile përveç metodave të zakonshme të mësimdhënies siç janë leksionet dhe seminarët, studentët marrin pjesë në punët laboratorike, japin detyra kursi dhe projekte, zhvillojnë prezantime etj. Departamenti ka organizuar disa aktivitete me përfaqësuesit e industrisë së Ndërtimit për të kuptuar më mirë pritshmëritë e tregut. Universiteti POLIS mbështet personelin e tij akademik për përmirësimin e kompetencave akademike nëpërmjet programeve ERASMUS+ për metodologjitë e mësimdhënies apo dhe të programit të ndërkombëtar të Doktoraturës në Arkitekturë dhe Planifikim Urban-IDAUP organizuar së bashku me Universitetin e Ferrara në Itali (rast ilustrues https://driveproject-eu.com). Gjithashtu, një mbështetje janë dhe përmirësimi i kompetencave të përdonelit akademik të qëndrimit nga 5 ditë deri në 6 muaj në institucione partnere ndërkombëtare për shkëmbime të eksperiencave në mësimdhënie dhe të kërkimit shkencorë.</p> <p>Referenca: Plani strategjik Universitetit POLIS, vitet 2023-2027</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie. Ky vlerësim fillon që në fazën e rekrutimit. Gjithashtu, gjatë vizitës në universitet, u diskutua mbi shpërndarjen e lëndëve të programit tek stafi akademik, e cila realizohej duke u bazuar në fushat e ekspertizës. Nga ana tjetër, personeli akademik i DIA-s përmirësohet vazhdimisht duke marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në aktivitete trajnimi brenda departamentit. Puna e stafit me studentët gjatë përgatitjes së diplomave Master është një tregues i efikasitetit të nxënies. Në takim me stafin akademik, Dr. M.K tregon përvojën e saj lidhur me përgatitjen e dy syllabuseve duke u nisur nga kërkesat e tregut, të normave të projektimit dhe Eurocodeve. Pas tërmetit të vitit 2020, praktikat e konstatuara në terren i janë përcjellë edhe studentëve në leksione.</p> <p>Referenca: Aneks 28, CV-të dhe kualifikimet e stafit të angazhuar në programin e studimit; Aneksi 25, Politikat e bashkëpunimit dhe marrëveshjet e partneritetit në funksion të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nëpërmjet mënyrave të ndryshme (RVB) institucioni thith mendimet dhe sugjerimet e vlerësimet anonime të studentëve në lidhje me metodat e mësimdhënies në klasë dhe problematikat e procesit mësimor dhe vlerësimin nga të barabartët (kolegët), vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga eprori. GVJ e vlerëson procedurën e këtij vlerësimi si mjaft efikase, vlerësim i cili i shërben drejtpërsëdrejti përmirësimit dhe përshtatjes me kushtet e reja të zhvillimit të shoqërisë, profesionit dhe tregut të punës. Drejtuesi i departamentit në fund të çdo semestri organizon takim individual me sejcilin grup mësimor për të diskutuar sugjerimet e studentëve dhe performancën për komponentët akademik, shkencor dhe atë administrative.</p>



	Referenca: Aneksi 17, Formularët për vetvlerësimin akademik dhe administrative; Aneksi 49, Raporti individual për vlerësimin e performancës vjetore të stafit; Minutat e takimeve me stafin akademik dhe studentët.			
Kriteri 6. Institucioni organizon Strukturë/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturët dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Universiteti POLIS për të siguruar cilësinë akademike vendimet i merr nëpërmjet organeve kolegjiale të tij si Senati Akademik, Këshillat e Fakulteteve, Rektorati etj (Aneks 4, Rregullore Didaktike). Parimet dhe metodat janë të detajuara në rregulloren mësimore të programit të studimit (Aneks 6, Rregullore e Programit të Studimit). GVJ gjatë vizitës në institucion dhe nga bisedat me stafin dhe studentët konstatoi se departamenti është i angazhuar të aplikojë metoda të reja dhe tërheqëse në mësimdhënie, duke u përpjekur të përfshijnë sa më shumë tematika që do të përdoren nga studentët gjatë punimit të diplomës. Bashkëpunimi ndërkombëtar në programin ERASMUS ka bërë të mundur të hartohen dhe përdoren metoda të ndryshme në mësimdhënie. Kështu, nëpërmjet projektit DRIVE, janë hartuar metoda në mësimdhënie që nxisin atësitë e studentëve në kërkim shkencor dhe në diskutime aktive për zgjidhje të situatave konkrete, shoqëruar me llogaritjet konstruktive përkatse dhe vizatimet grafike respektive. GVJ, mendon se me këto zgjedhje ia ka arritur të inkurajohet ndjenja e pavarësisë tek studentët, puna në grup dhe të menduarit krijues, duke ndërtuar kështu edhe një mjedis bashkëpunues, ku studentët janë të lirë të zhvillojnë në mënyrë pavarur në aktivitetet e pjesëmarrjen e tyre për kërkime shkencore. Referenca: Aneks 4, Rregullore Didaktike; Aneks 6, Rregullore e Programit të Studimit; Aneks 21, Agjenda e Kërkimit Shkencor.			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson metodat që aplikohen në mësimdhënies/mësimnxënie nxisin mendimin krijues, kritik dhe autonominë e studentëve. Institucioni mbështet stafin akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike në plotësim të objektivave formues dhe kërkesave që shtron tregu i punës. Mësimdhënia në Universitetin POLIS rezulton të jetë e larmishme në varësi të specifikave të lëndëve dhe nevojave të studentëve. Ofrohen mundësi të barabarta për të gjithë studentët, pavarësisht nivelit të përgatitjes së tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e	GVJ gjatë vizitës vlerësuese konstaton që Programi Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi kryen vlerësime të vazhdueshme të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale gjatë gjithë periudhës kohore të studimeve. Rregullore e Përgjithshme dhe Rregullore e Programit të Studimeve (të cilat janë publike); japin detaje të mjaftueshme dhe bindëse që ky Kriter plotësohet në të gjitha parametrat e tij.



<p>Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Mënyrat për vlerësimin e ndërmjetmë dhe atë përfundimtarë të studentëve deklarohen nga pedagogët që me fillimin e studimeve për çdo lëndë dhe modul. GVJ, mendon se plotësimi i këtij Kriteri garanton dhe përmirëson jo vetëm performancën e studentëve gjatë procesit akademik por njëkohësisht krijon kushte për pedagogët që, të përshtasin metodat në mësimdhënie sipas rezultateve të klasës në përgjithësi dhe t'i kushtojnë vëmendje më të madhe studentëve që hasin vështirësi në faza të ndryshme të procesit mësimorë.</p> <p>Referenca: Aneksi 3, Rregullore e Përgjithëshme; Aneksi 6, Rregullore e Programit të Studimeve.</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Me fillimin e vitit mësimorë akademik, studentët njihen jo vetëm me pedagogët titullarë të lëndës por edhe me programet përkatëse të lëndëve/moduleve, të cilat janë të miratuara nga Dekani i Fakultetit përmbajtjen dhe planin e lëndës, metodologjinë dhe mënyrat e vlerësimin të njohurive të tyre. GVJ, vlerëson pozitivisht metodologjinë e testimit dhe të vlerësimin të njohurive që ndiqen në Universitetin POLIS, siç janë: 1. Nëpërmjet platformës Pitagora studentëve i lejohet akses i plotë të sigurojë informacion për çdo lëndë që ata kanë rregjistruar në çdo semestër. 2. Programi i Studimeve ne Master i Shkencorë, profili “Strukturë” gjendet lehtësisht edhe në faqen zyrtare të Universitetit POLIS. 3. Me fillimin e vitit akademik, pedagogët i paraqesin studentëve planin mësimor, formularët e vlerësimin, temat që do të zhvillohen, detyrat, punët në terren dhe atë të studimit individual.</p> <p>Referenca: Aneksi 27, Syllabuset e lëndëve.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ u njoh edhe me format dhe mënyrat e testimit të dijeve të fituara nëpërmjet takimeve me Përgjegjësin e Departamentit duke u përqëndruar në mësimdhënien dhe mësimnxënien. Për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të të nxënit departamenti përdor mënyra të ndryshme për këtë program studimi, në varësi të lëndëve dhe specifikimeve që ato mbartin duke zbatuar parimet e rregullores universitare dhe kërkesave të lëndës. Vlerësimi i studentëve kryhet gjatë gjithë vitit, nëpërmjet provimeve periodike, seancave të përgatitjes së detyrave/prajekteve të kursit, bashkëbisedimit dhe shkëmbimeve të mendimeve në grup, punëve laboratorike dhe provimeve përfundimtare. GVJ, në takimet me studentët krijoji bindjen e Tij, se nëpërmjet këtyre formave të testimit, studentët kanë mundësi të plota për të demonstruar nivelin e tyre të njohurive të fituara gjatë semestrit dhe vitit akademik.</p> <p>Referenca: Minuta të takimit me studentët, (17.01.2024, ora 12.00)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson takimet me Dekanin, Përgjegjësin e departamentit, stafin dhe studentët dhe u njoh me format dhe mënyrat e testimit të dijeve të fituara nga studentët dhe vlerëson se ato janë në përputhje me parimet e rregullores universitare dhe kërkesave për çdo lëndë/modul; Informacionin për procedurat e testimit, vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore që studentët i sigurojnë drejtpërdrejtë dhe elektronikisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në rregulloren e përgjithëshme të programit të studimit janë të përcaktuara mënyrat e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe më pas detajohen në rregulloren didaktike (Aneks 4, Rregullore Didaktike) dhe programit të studimit. GVJ konstaton që i gjithë dokumentacioni dhe informacioni i nevojshëm përgatitet dhe shpërndahet nga Sekretaria mësimore. Me këtë rast të gjithë studentët marrin një adresë e-mail të dedikuar emri_mbiemri@universitetipolis.edu.al në momentin e regjistrimit. Sipas rregullores, testimi i njohurive të studentëve vlerësohet me sitemin e pikëve për: pjesëmarrje dhe aktivizim, detyra e kursit, projekte etj, laboratorët, provimet e ndërmjetme dhe provimi përfundimtar. Në nivel program studimi, studenti vlerësohet edhe për praktikën mësimore dhe detyrimet përfundimtare, që ata kanë përpara mbrojtjes së diplomës. Teza e provimit është një kombinim i pyetjeve teorike (me zbrëthim konceptesh), ushtrime praktike dhe raste aplikative të ndryshme. Vlerësimi dhe shpërndarja e pikëve të lëndës, realizohet sipas tezës së provimit që përmban 100 pikë, ndërsa shpërndarja e e vlerësimit (pikët) është në kompetencë të pedagogut të lëndës.</p> <p>Referenca: Aneksi 4, Rregullore e përgjithëshme dhe Rregullore didaktike.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Universiteti POLIS aplikon një sistem elektronik Google Classroom, i cili është i qëndrueshëm dhe funksional për ruajtjen e shënimeve të studentëve të tyre dhe mësimdhënësve. GVJ nga takimet në institucioniu bë present se abuzime dhe mungesë e transparencës nuk janë hasur ndonjëhere, megjithatë vëmëndja dhe kujdesi ndaj këtyre formave abusive është shumë i lartë. Dorëzimet dhe vlerësimet e detyrave të ndërmjetme dhe përfundimtare të studentëve kryhen fizikisht dhe elektronikisht.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Provimi përfundimtar vlerësohet nga një komision, në përbërje të të cilit asistojnë jo më pak se dy pedagogë nën drejtimin e titullarit të lëndës. Komisionet e provimeve janë të ngritura nga departamenti dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit në përputhje me Rregulloren e Përgjithëshme të Institucionit.</p> <p>Referenca: Aneks 3, Rregullore e Përgjithëshme.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturë të mjaftueshme për vlerësimin e njohurive dhe punës individuale të studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë gjatë orëve të seminareve stafi akademik u ofron studentëve komente/feedback për arritjet dhe performancën e tyre për përvetësimin e njohurive në seminare/laboratore, nivelit të përgatitjes apo prezantimit të detyrave kursit/projekteve duke dhënë vlerësime dhe këshilla/ orientime për të përmirësuar performancën e tyre në të ardhmen.</p>

<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Natyra e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, kërkon që pjesa më e madhe e detyrave, prezantimeve dhe mbrojtja e detyrave/projekteve të kursit, të kryhen duke kaluar nëpërmjet një procesi të gjatë pune në studio dhe konsultimesh të vazhdueshme me pedagogët e lëndëve. Janë këto arsye pse procesi i anonimizimit, sekretimit dhe kodifikimit në Universitetin POLIS janë konsideruar të panevojshëm. GVJ gjatë vizitave dhe kontakteve në departament, mëson se kur natyra e lëndës kërkon kushte të veçanta të testimit, institucioni vë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme fizike dhe personel të shtuar për të monitoruar procesin. Të gjitha punimet studimore dhe me përmbajtje kërkimore shkencore verifikohen në systemin online antiplagjaturë Turnitin (https://www.turnitin.com) dhe vlerësimi pozitiv i sistemit është kusht detyrues për t'u pranuar.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qarte dhe të shpallura. Ato monitorohen dhe ndiqen nga afër nga institucioni gjatë gjithë procesit mësimor në përputhje me rregulloren e universitetit dhe specifikimeve të syllabuseve. Rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen në meritën e studentëve dhe i bëhen të ditura në mënyrë individuale studentëve me paraqitjen fizike të tyre ashtu edhe online.</p> <p>Reference: Rregullore e Programit të Studimit, Rregullore Përgjithshme e U POLIS, Statuti i Universitetit POLIS</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit, si dhe gjatë vizitës në universitet GVJ konstaton se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u njohur me vlerësimin, të diskutojë për pakënaqësitë ndaj këtij procesi apo edhe për t'a kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankesë për rishikim nga ana e komisionit të vlerësimit në departament dhe/ose dekanatit. Ankesa paraqitet në formën e një formulari të veçantë, brenda një jave pas shpalljes së rezultateteve përfundimtare. Nëqoftëse edhe ky rivlerësim nuk pranohet nga ana e studentit, atëherë studenti sipas rregullores ka të drejtën të kërkojë ngritjen e një komisioni të pavarur për rishqyrtimin e detyrës, testit apo dorëzimit të projektit etj.</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në rast se studenti shfaq ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit si kontrolle, provim i ndërmjetmë, detyra kursi/projekte, provim përfundimtar etj, komisioni i vlerësimit pasi ka shqyrtuar ankesën njofton studentin dhe sekretarinë mësimore nëse ka patur ose jo ndryshim nga vlerësimi i mëparshëm. Në rastet kur studenti kërkon ngritjen e një komisioni tjetër, ata (studentët) vihen në dijeni të përbërjes së komisionit dhe sipas rastit i kërkohen shpjegime dhe sqarime studentëve për punën e kryer. Ashtu si në rastin e parë edhe në këtë rast, vlerësimi i komisionit i bëhet me dije studentit dhe sekretarisë mësimore. Më pas i gjithë procesi dokumentohet dhe vlerësimi arkivohet.</p> <p>Reference: Rregullore e Programit të studimit, Rregullore Përgjithshme e U POLIS, Statuti i Universitetit POLIS</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson testimin e njohurive të studentëve me sistemin e pikëve për pjesëmarrje dhe aktivizim, detyra e kursit, projekte etj,</i></p>



	<p>laboratorët, provimet e ndërmjetme dhe provimi përfundimtar. Provimi përfundimtar vlerësohet me komision, në përbërje të të cilit asistojnë jo më pak se dy pedagogë nën drejtimin e titullarit të lëndës. Komisionet e provimeve janë të ngritura nga departamenti dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Studentët e ushtrojnë të drejtën për t'u njohur me vlerësimin, të diskutojnë për pakënaqësitë apo edhe për t'u kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankesë për rishikim nga ana e komisionit të vlerësimit në departament apo edhe të kërkesës për ndryshim të komisionit. I gjithë procesi i vlerësimit të studentëve dokumentohet dhe arkivohet.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë studimi. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar të njohurive në ciklin e dytë master. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik nëpërmjet praktikave mësimore dhe internshipe të studentëve. Përveç kurrikulës, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtë-kurrikulare, siç janë aftësimi dhe zgjerimi i njohurive profesionale në studiot e projektimit, forume të hapura, vizita në terren, konferenca studentore, trajnime, kurse etj. Reference: Plani mësimor i PS, programet e lendeve</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Për të përmbushur këtë kriter në planin mësimor të programit të studimit janë përfshirë shumëllojshmëri fushash e aftësish të veçanta. Gjithashtu për zhvillimin e aftësive të veçanta, në planin mësimor janë përfshirë lëndë të tilla si Teknologjia e Informacionit; Koncepte dhe Parime të modelimit të informacionit në Ndërtim; Ndërtimi i skemave llogaritëse dhe modeleve kompjuterike të ndërtesave nëpërmjet simulimeve statike-sizmike në programe në gjuhën angleze etj. Referencë: Program i studimit etj.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen në përfundim të semestrit dhe vitit akademik. Pedagogët tërheqin mendimin e studentëve për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të përmbajtjes së lëndëve. Diskutimi për rezultatet e mësimdhënies dhe aftësitë e fituara lidhur me pritshmëritë diskutohen edhe në prani të studentëve (në kuadër të feedback për rritjen profesionale të tyre) dhe më pas vazhdojnë në diskutime të brendshme të stafit për të vlerësuar efektivitetin e metodave të përdorura lidhur me objektivat e vendosura të syllabusit. Si test për të kuptuar se sa kanë përfituar studentët është dhe momenti I dorëzimit të</p>

	detyrave/projekteve të kursit apo detyrat praktike, që realizohet në javën e 13-të. Edhe përgjegjesi i departamentit dhe dekani në prani të përgjegjësve të programit të studimit marrin në shqyrtim arritjet dhe problematikat në bazë lëndësh dhe grupe lëndësh nëse ka patur gjatë vitit akademik për programin e studimit dhe krahasimin e tyre me objektivat e vendosura për programin e studimit.
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpercaktuara në programet e lëndëve. Stafit akademik nxitet nga institucioni që të zhvillojë aftësitë e tij profesionale në programin e studimit inxhinieri ndërtimi, e cila konsiderohet si një drejtim në zhvillim dhe përditësim të vazhdueshëm përfshirë edhe kërkimin shkencorë. Për lëndë specifike, mungesa e një laboratorit të dedikuar për programin e inxhinierisë së ndërtimit në mjediset e Institucionit, është zgjidhur nga bashkëpunimi me laboratorë testues të akredituar nga DPA (Drejtoria e Përgjithëshme e Akreditimit) siç është ALTEA & Gjeostudio 2000, Laborator i Testimeve në fushën e Materialeve të Ndërtimit dhe ato Gjeoteknike si dhe praktikat profesionale. Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit Master në Inxhinieri Ndërtimi. Nga vizita në universitet dhe takimi me studentët GVJ kuptoi se ata inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në punimet e detyrave/projekteve të kursit, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bilaterale për shkëmbimin e studentëve, lista e të cilave është vënë në dispozicion të GVJ. Universiteti POLIS shkëmben përvojën e tij me këto universitete duke mundësuar rritjen e mobiliteteve të studentëve. Referencë: Kurrikula e programit të studimit</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti POLIS ka një traditë të mirë oraganizimin e orëve të hapura për prezantime si nga stafi akademik efektiv dhe të ftuar ashtu sikundër nga personalitete të shquara në fushën akademike dhe profesionale, aktivitete mbi zhvillimet e reja të shkencës së ndërtimit por edhe më gjerë, që janë quajtur me të drejtë "Open Forum" sepse këto prezantime janë shfrytëzuar njëkohësisht edhe si momente të ballafaqimit të eksperiencave. Një bashkëpunim me mjaft interes i departamentit të Inxhinierisë është ai me Institutin Kërkimor Amerikan në fushën e Inxhinierisë së tërmeteve EERI, institucione nga rajoni për hartimin e raportit të dëmeve të tërmetit të 26 Nëntorit 2019. Për studentët këto aktivitete janë një gjetje e zgjuar pasi përfitimet nga eksperiencat e përparura të shkencës e teknologjisë në fusha të arkitekturë, dizajn, urbanistikë, materialeve dhe inxhinierisë së ndërtimit janë me efektivitet konkret në formimin profesional e kulturor të tyre. Disa kontribute me përfaqësim vendas dhe të huaj kanë qenë: Prof. S. B (Kanada), Prof. A. H (SHBA), Prof. A. Ch. (Zelandë e Re), Prof. D. A. (Itali), Prof. I. I. (Maqedonia e Veriut), Prof. R. M (Japoni), Prof. D. F (Japoni), Prof. J. C.M (Portugali), Prof. M. M. (Japoni), Msc. N. K (Gjermani), Msc. K. M (Shqipëri), Msc. G.K (Shqipëri), Msc. B.G (shqipëri), Msc. B. M (Shqipëri) etj.</p>

<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Qendra Innovation Factory, brenda Universitetit e bën të mundur këtë mbështetje nëpërmjet vënies në dispozicion të tyre të pajisjeve, asistencës teknike dhe trajnime në fushën e inovacionit madje për studentë të talentuar ofron edhe skema bashkëfinancimi me biznese për projekte me interes. Gjatë vitit 2023 janë organizuar dy thirrje për studentët nga të cilat kanë përfituar disa studentë. Universiteti POLIS është një nga partnerët themelues të Tirana Inc. si qendra e bizneseve, që ofron mbështetje dhe financim të të rinjve novatorë (https://www.tirana-inc.al/).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Programi synon aftësimin praktik nëpërmjet praktikave mësimore dhe internshipe të studentëve. Në planin mësimor janë përfshirë lëndë si Teknologjia e Informacionit; Koncepte dhe Parime të modelimit të informacionit në Ndërtim dhe Ndërtimi i skemave llogaritëse dhe modeleve kompjuterike të ndërtesave nëpërmjet simulimeve statike-sizmike me programe në gjuhën angleze. Me mjaft interes për studentët vlerësojmë bashkëpunimin e departamentit të Inxhinierisë me Institutin Kërkimor Amerikan në fushën e Inxhinierisë së tërmeteve EERI dhe shumë institucione të tjera nga rajoni për hartimin e raportit të dëmeve të termetit të 26 Nëntorit 2019. Një kontribut interesant jep edhe "Qendra Innovation Factory", e cila mbështet studentët duke i inkurajuar për shpалosjen e ideve novative dhe promovim të punimeve të tyre shkencore. Gjatë vitit 2023 janë organizuar dy thirrje për studentët nga të cilat kanë përfituar disa studentë. Universiteti POLIS është një nga partnerët themelues të Tirana Inc. si qendra e bizneseve, që ofron mbështetje dhe financim të të rinjve novatorë (https://www.tirana-inc.al/).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmblyëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Procedura për provimin final apo në rastin e këtij programi studimi të emërtuar mbrojtja e diplomës nga ana e studentëve është e hartuar qartë dhe e parashikuar në rregulloren e Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajn, në të cilën bëjnë pjesë të gjitha modalitetet e mbrojtjes së diplomës. Ajo është e publikuar në faqen e internetit, nga ku studentët mund t'a aksesojnë lehtësisht atë në mënyrë të pavarur. Studentët njoftohen edhe zyrtarisht me e-mail mbi këtë procedurë. Nëpërmjet këtij njoftimi çdo student i programit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi vihet në dijeni edhe të listës së dokumentacionit që duhet të dorëzojë përpara mbrojtjes së diplomës.</p>


	Referenca: Aneksi 7, Rregullore e Diplomimit.
Kriteri 2. Strukturët përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Udhëzimet mbi mbrojtjen e diplomës i vihen në dispozicion studentëve si rregull brenda tremujorit të parë të vitit të fundit. Dokumentacioni, arkivat e Universitetit si dhe bibliotekat fizike dhe elektronike janë në dispozicion të studentëve. Nga vizita në universitet, GVJ konstaton se dekanati dhe departamenti ka caktuar një grup pedagogësh që organizojnë çdo javë konsulta me studentët diplomantë për të ndihmuar nga afër jo vetëm përzgjedhjen e temës së diplomave por edhe më vonë në kontrollin dhe avancimin e punimit të diplomës. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që për t'i ndihmuar të kryejnë punën e tyre kërkimore shkencore. Për realizimin e diplomës departamenti ka vendosur disa afate për fazën përgatitore (lista e studentëve të miratuar), fazën e parë (miratimi i temave të diplomave), fazën e dytë (zhvillimi i temës së diplomës), fazën e tretë (kontrollat nga komisioni i ngritur për këtë qëllim) dhe fazën e katërt (dorëzimi, mbrojtja e diplomës dhe provimi final i njohurive). Një komision prej tre vetësh, 2 (dy) nga departamenti dhe 1 (një) nga zyra juridike e Universitetit POLIS marrin në dorëzim punimet e diplomave të studentëve. Nga takimi me studentët, ata pohojnë se zyra e mbështetjes së studentëve dhe karrierës marrin një mbështetje dhe trajnime gjatë gjithë periudhës së studimeve. Referenca: Aneksi 7, Rregullore e Diplomimit.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i posaçëm për mbrojtjen e diplomave bazohet në punimin e diplomës dhe tezës së shkruar, e cila në vetvehte përmbledh të gjithë fushën e njohurive që studentët diplomantë kanë fituar në lëndët dhe modulet e programit mësimor të përmbledhur në punimin e diplomës në programin dy vjeçar të studimit Master i Shkencës në Inxhinieri Ndërtimi, profili "Strukturë". Komisioni për mbrojtjen e diplomave ka në përbërje të tij staf me profile të ndryshme në gjendje të mbulojnë të gjithë spektrin e tematikave të diplomave të grupit të studentëve që paraqiten për mbrojtje të diplomave. Referenca: Aneksi 7, Rregullore e Diplomimit.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Nga vizita në universitet, takimi me studentët dhe shqyrtimi i syllabusit përkatës GVJ mëson që, stafi akademik përgjegjës për provimin e përfundimtar apo mbrojtjen e diplomës është një procedurë e qartë që, përfshin: përzgjedhjen e temës së diplomës; ku synohet që studentët të nxiten për t'a bërë ata vetë propozimin e parë të temës së diplomës, duke krijuar studentit mundësi për të zhvilluar iniciativën e lirë dhe krijimit të ideve të reja. Udhëheqësi i studentëve diplomantë (mund të zgjidhen nga vetë studentët ose i propozohen nga departamenti) është përgjegjës për organizimin dhe ndjekjen e orareve të konsultimeve, zhvillimin e seancave metodologjike, ndihmën për shkrimin e temës së diplomës, në përshkrimin e përfundimeve si edhe nxjerrjen e konkluzioneve e rezultateve përkatëse. Referenca: Aneksi 21, Agjenda e kërkimit shkencorë.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e	Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve apo testeve në mjediset e institucionit apo edhe jashtë tij të vëna në dispozicion të tyre. Mangësitë e një pjese të pajisjeve laboratorike brenda mjedisëve të institucionit nuk e çojnë cilësinë e kërkimit shkencorë për realizimin

<p>institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>e temave të diplomave sepse studentëve i vihet në dispozicion gjithçka është në pronësi të institucionit nga njëra anë por edhe jashtë institucionit nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me laboratorin Altea & Gjeostudio 2000 etj.</p>			
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës vlerësohen me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit.</p> <p>Reference: DVV, RVB</p>			
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës si dhe kopjen e plotë të programit të studimit të kryer të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Nëpërmjet sekretarisë mësimore, studentit i vihen në dispozicion kopje zyrtare, të silabuseve të programit të studimit. Suplementi i diplomës ofrohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Në të pasqyrohen të dhëna të detajuara mbi programin e studimit të zhvilluar.</p> <p>Reference: Aneks 18, Modeli i diplomës dhe Suplementi i Diplomës, Aneks 41, Model Kurs Katalogu i Programit</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni ka krijuar një bazë të dhënash (arkivë) të plotë si fizikisht por edhe elektronike për të gjithë procesin mësimor; lëndët, orët, kreditet dhe vlerësimin me nota, notën mesatare dhe notën përfundimtare. Dokumentacioni ruhet për një periudhë pa afat. Gjatë vizitës në sekretari, GVJ u njoh me vëllimin e punës që kryhet për vlerësimin në të gjitha lëndët dhe për gjithë periudhën e studimeve, numurin e matrikulimit, rezultatet në hyrje dhe në dalje të secilit prej tyre. Të dhënat përpunohen periodikisht në mënyrë statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, agjensinë e sigurimit të cilësisë, apo të vetë institucionit. GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të Universitetit POLIS, specifikisht gjatë kontrollit të të katër rregjistrave, nuk konstatoi korigjime, si në nota ashtu edhe në të dhënat e studentëve. Reference: DVV, RVB.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Informacioni dhe udhëzimet mbi mbrojtjen e diplomës është i plotë. Temat e diplomave zgjidhen nga vetë studentët ose i propozohen nga departamenti. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës si dhe kopjen e plotë të programit të studimit të kryer në gjuhën shqipe dhe angleze të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Institucioni ka krijuar një bazë të dhënash (arkivë) të plotë për të gjithë procesin mësimor; lëndët, orët, kreditet dhe vlerësimin me nota, notën mesatare dhe notën përfundimtare dhe ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>



Standardi III.6				
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky Standard dhe kriteret e tij nuk janë pjesë e këtij Programi studimi.			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfundimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione	-			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRA STRUKTURË, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																														
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Në shqyrtim të dokumentacionit të DVV, takimit me stafin akademik të angazhuar me programin e studimit si dhe takimit me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike GVJ konstatohet që personeli akademik efektiv dhe me kontratë si dhe personeli ndihmës akademik, i angazhuar në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Ai ka nivelin e duhur të kualifikimit për drejtimin e PS” Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profil Strukturë”. Personeli akademik i angazhuar me këtë PS mbulonte të gjitha lëndët/modulet mësimore të programit. I gjithë aktiviteti i tij shkencor lidhej me fushën kërkimore të programit të studimit. Konkretisht, për PS “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil Strukturë”, Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit kishte angazhuar, sipas viteve, personelin akademik si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë departament 28 pedagogë nga të cilët 20 PAE dhe 8 PAK (71.4 % /28.6 %); 2. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë departament 30 pedagogë nga të cilët 22 PAE dhe 8 PAK (73.3 % /26.7 %); 3. Për vitin akademik 2023 - 2024 japin mësim mësim në këtë departament 29 pedagogë nga të cilët 21 PAE dhe 8 PAK (72.4 % /27.6 %); <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th rowspan="2" style="text-align: center;">Tituj/ grada</th> <th colspan="2" style="text-align: center;">2021-2022</th> <th colspan="2" style="text-align: center;">2022-2023</th> <th colspan="2" style="text-align: center;">2023-2024</th> </tr> <tr> <th style="text-align: center;">PAE</th> <th style="text-align: center;">PAK</th> <th style="text-align: center;">PAE</th> <th style="text-align: center;">PAK</th> <th style="text-align: center;">PAE</th> <th style="text-align: center;">PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;">Prof.Dr.</td> <td style="text-align: center;">1</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">-</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">Prof. Asoc.</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">2</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">1</td> <td style="text-align: center;">-</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">Doc Dr</td> <td style="text-align: center;">1</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">2</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">2</td> <td style="text-align: center;">-</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">Dr./PhD.</td> <td style="text-align: center;">6</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">9</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">8</td> <td style="text-align: center;">1</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">Kandidat Dr.</td> <td style="text-align: center;">5</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">4</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">5</td> <td style="text-align: center;">-</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">Msc.</td> <td style="text-align: center;">7</td> <td style="text-align: center;">8</td> <td style="text-align: center;">5</td> <td style="text-align: center;">8</td> <td style="text-align: center;">5</td> <td style="text-align: center;">7</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">Totali</td> <td style="text-align: center;">20</td> <td style="text-align: center;">8</td> <td style="text-align: center;">22</td> <td style="text-align: center;">8</td> <td style="text-align: center;">21</td> <td style="text-align: center;">8</td> </tr> </tbody> </table>	Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	1	-	-	-	-	-	Prof. Asoc.	-	-	2	-	1	-	Doc Dr	1	-	2	-	2	-	Dr./PhD.	6	-	9	-	8	1	Kandidat Dr.	5	-	4	-	5	-	Msc.	7	8	5	8	5	7	Totali	20	8	22	8	21	8
Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024																																																										
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																									
Prof.Dr.	1	-	-	-	-	-																																																									
Prof. Asoc.	-	-	2	-	1	-																																																									
Doc Dr	1	-	2	-	2	-																																																									
Dr./PhD.	6	-	9	-	8	1																																																									
Kandidat Dr.	5	-	4	-	5	-																																																									
Msc.	7	8	5	8	5	7																																																									
Totali	20	8	22	8	21	8																																																									

Ndërsa për PS “Master shkencor në Inxhinieri Ndërtimi me profil Strukturë”, personeli mësimdhënës sipas viteve rezultojn:

1. Për vitin akademik 2021- 2022, 17 pedagogë nga të cilët 13 PAE dhe 4 PAK (76.5 % /23.5 %);
2. Për vitin akademik 2022- 2023, 14 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 4 PAK (71.4 % /28.6 %);
3. Për vitin akademik 2023 - 2024 japin mësim mësim 11 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 4 PAK (63.7 % /26.3 %);

Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	-	2	-	-	-
Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	-
Doc Dr	1	-	1	-	1	-
Dr./PhD.	3	-	4	-	4	1
Kandidat Dr.	6	-	1	-	-	-
Msc.	1	4	2	4	2	3
Totali	13	4	10	4	7	4

Përsa i përket përballimit të ngarkesës mësimore rezultojn që ngarkesa e përgjithshme në Msc profili stukturë prej 1192 orësh mësimore përballohet në masën 72.3% (862 orë) nga PAE dhe 27.6% (330 orë) nga PAK, duke përmbushur kështu detyrimin ligjor për shpërndarje të ngarkesës në masën jo më pak se 70% PAE dhe jo më shumë se 30% PAK.

Sa i përket shpërndarjes së ngarkesës mësimore rezultojn që ajo në të gjitha rastet është më e madhe se norma e përcaktuar në udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 të MASR. Në tre raste për pozicionin e lektorit ajo e kalon edhe masën e normës+200 orë suplementare. Po ashtu ky tejkallim rezultojn, në këtë masë, edhe në dy raste për gradën Msc. GVJ vleron që, edhe pse udhëzimi i cituar e lejon këtë tejkallim për raste specifike, institucioni duhet të marrë masa për rritjen e numrit e PAE dhe zvogëluar ngarkesën e tij në auditor.

Struktura moshore lëviz nga 25 deri në 45 vjeç (viti 2023-2024) përveç një lektori me gradë Dr. që është mbi 56 vjeç.

Angazhimi në procesin mësimor rezultojn i tillë: në pozicionin e lektorit është personeli me gradë shkencore Dr. dhe ai i kategorisë profesor. I

	<p>gjithë personeli me grada shkencore Kandidat për Dr. dhe Msc angazhohet kryesisht si asistent lektor. Ngarkesa e këtij personeli kundrejt ngarkesës së personeli me gradë Dr dhe të kategorisë profesor është në raportin 884/308 dhe në % 74.2% me 25.8%. <i>GVJ gjykon që angazhimi i personelit me gradë shkencore Msc në masën e cituar prej 25.8%, edhe pse jo në pozicionin e lektorit, nuk është në përmbushje të kërkesës së ligjit 80/2015, neni 59 pika 6.</i></p> <p><i>Referenca:</i> -<i>RVB</i> -<i>Shënime nga vizita në Institucion</i> -<i>Tabelat përmbledhëse</i> - <i>Aneks 14_Guida e Stafit</i> - <i>https://www.universitetipolis.edu.al/</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil Strukturë” zhvillohet në 2 vite shkollorë (4 semestra). Plani mësimor përmban gjithsej 18 lëndë+ praktika profesionale + teza e diplomës. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Peshat që zënë kategoritë respektive për këtë PS janë:</p> <p>Kategoria A 8% (Lëndë Bazë)</p> <p>Kategoria B 53% (Lëndë karakterizuese)</p> <p>Kategoria C 15% (Lëndë ndërdisiplinore/integruese)</p> <p>Kategoria D 10% (Lëndë plotësuese)</p> <p>Kategoria E 15% (Detyrime përmblylëse)</p> <p><i>Referenca:</i> -<i>RVB</i> -<i>Shënime nga vizita në Institucion</i> -<i>Tabelat përmbledhëse</i> - <i>Aneks 3_Rregullore Përgjithshme,</i> - <i>Aneks 44_Strategjia e Burimeve Njerëzore</i> - <i>https://www.universitetipolis.edu.al/</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Referuar numrit të stafit të angazhuar për këtë PS gjatë viteve 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024 numri i PAE është zvogëluar me përkatësisht 3 në vitin paraardhës kundrejt vitit pasardhës, pra nga 13 në vitin 2021-2022 në 7 në vitin 2023-2024. Ndërkohë që numri i PAK ka mbetur konstant.</p> <p><i>GVJ rekomandon që në interes të PS do të duhej që ky numër të stabilizohej për të mos patur disbalancime në shpërndarjen e ngarkesës. Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore GVJ konsultoi dosjet e personelit dhe gjeti që ato ishin të plota konform kërkesave ligjore.</i></p> <p><i>Referenca:</i> -<i>RVB</i> -<i>Shënime nga vizita në Institucion</i> -<i>Tabelat përmbledhëse</i> - <i>Aneks 45_Model kontrate PAK-PAE</i> - <i>https://www.universitetipolis.edu.al/</i></p>



<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në materialet e DVV, vizitën në zyrën e burimeve njerzore, takimin me personelin akademik dhe konsultimin e faqes zyrtare në internet të Universitetit Polis https://universitetipolis.edu.al/puncsimi/. GVJ konstaton që në këtë IAL ndiqen të gjitha procedurat ligjore të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit, të cilat garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion --Tabelat përmbledhëse - Aneks 46_Formular per shpalljen e vendit kandidat - Aneks 47_Formular vlerësimi gjatë procesit të rekrutimit - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Referuar CV-ve të personelit ndihmës akademik të angazhuar me PS, Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil Strukturë”, ngarkesës në syllabuset e lëndëve përkatësisht moduleve, aktiviteteve mësimore dhe vizitave në auditoret dhe labororet ku zhvillohet procesi mësimor, GVJ konstaton që Universiteti Polis siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin çdo vit akademik të të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil Strukturë” në universitetin Polis, është përgjegjëse zyra e Burimeve Njerzore dhe Çështjeve Juridike, e cila disponon bazën e plotë për të gjithë personelin akademik të angazhuar në PS së bashku me dokumentacionet e nevojshme ligjore.. GVJ i konsultoi burimet e të dhënave për këtë kriter dhe konstaton plotësimin e tij.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - Annex 14 Guida e Stafit https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, nga lista prej 57 institucioneve dhe organizatash me të cilat Universiteti Polis bashkëpunon në nivel institucional, GVJ shqyrtoi disa marrëveshje si psh atë të bashkëpunimit me kompaninë “Altea Geostudio 2000”, objektivi i bashkëpunimit me të cilën ishte vizita studimore dhe punë laboratorike, marrëveshjet me kompanitë “Rehau”, “KNAUF”, “Megatek” etj me objekt bashkëpunimi praktikat profesionale etj , marrëveshjet me UPT, UT etj me objekt</p>

<p>instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>bashkëpunimin për shkëmbim të kapaciteteve dhe njohurive teknike dhe konstaton që si nga ana e Universitetit Polis ashtu edhe nga institucionet e kompanitë bashkëpunuese janë zhvilluar mekanizma për një bashkëpunim të frytshëm me interes për procesin mësimor. Në takimin me studentët ata pohuan vlerat e këtyre bashkëpunimeve, kryesisht në zhvillimin e punëve laboratorike, zhvillimin e praktikave profesionale dhe realizimin e punimeve të diplomës.</p> <p><i>Referenca:</i> - R/VB - Shënime nga vizita në Institucion - Tabelat përmbledhëse - Aneks 42_Institucionet dhe organizatat ne bashkepunim ne nivel institucional - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Për PS “Master shkencor në inxhinieri ndërtimi me profil Strukturë” janë nënshkruar rreth 13 marrëveshje me objekt bashkëpunimi “praktikat profesionale”. Gjatë takimit me studentët GVJ u informua që nëpërmjet këtij bashkëpunimi realizohet me cilësi të mirë zhvillimi i praktikës profesionale. Sipërmarrjet e kontraktuara vënë në dispozicion personel mbikqyrës i cili dokumenton aktivitetin dhe së bashku me koordinatoren e programit të studimeve hartojnë raportin përfundimtar të praktikës që shërben si bazë për vlersimin e tyre.</p> <p><i>Referenca:</i> - R/VB - Shënime nga vizita në Institucion -- Aneks 43_Formulari për kryerjen e praktikës-intershipit - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që tek Universiteti Polis personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush kryesisht standardet lidhur me angazhimin e personelit me tituj dhe grada shkencore pasi ka të angazhuar me mësimdhënien personel me kualifikim më të ulët se kualifikimi i ciklit pasardhës (Msc) duke rënë ndesh kështu me kërkesën e ligjit 80/2015 neni 59 pika 6. Nisur nga ky fakt. GVJ rekomandon angazhimin e institucionit për përmbushjen plotësisht të këtij standardi. Po ashtu GVJ nisur nga ndryshimet në raportet PAE/PAK gjatë tre viteve të fundit, rekomandon që të bëhen përpjekje për të siguruar qëndrueshmëri të këtij raporti, në mënyrë që të mos shbalancohet ngarkesa e pedagogëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Duke shqyrtur dokumentacionin e DVV si dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Universiteti Polis siguron ambiente për zhvillimin e aktivitetit mësimor e kërkimor shkencor, në vartësi të numrit të studentëve dhe grupeve mësimore. Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi ambientet e vëna në dispozicion për PS “Mastër shkencor në inxhinieri ndërtimi, profili strukturë” dhe konstaton që si auditorët ashtu edhe mjediset laboratorike janë të paisura me pajisjet dhe teknologjitë e duhura për zhvillimin me cilësi të procesit mësimor. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - <u>Anekset 26.1.2.3.4.5.6.7-ambientet</u> - <u>https://www.universitetipolis.edu.al/</u>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ konstaton që ky kriter plotësohet në nivel bashkëkohor. Të gjitha auditorët, klasat dhe labororet ishin të paisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantonin realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Në takimin me studentët, GVJ u informua që metodat e mësimdhënjes për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë” ishin edhe të larmishme dhe eficiente. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - <u>Anekset 26.1.2.3.4.5.6.7-ambientet</u> - <u>https://www.universitetipolis.edu.al/</u>
Kriteri 3. Labororët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ vizitoi labororet SAP/ETABS/ BIM dhe FAB të cilët përdoren për llogaritje të Strukturëve të ndryshme si dhe kryerjen e analizave laboratorike. Po ashtu ai u informua dhe për përdorimin nga ana e studentëve të këtij profili të laboratorit të firmës “Altea & Geostudio 2000”, me të cilën kishin marrveshje bashkëpunimi. Në takimin me studentët GVJ mësoi që në këtë laborator ata realizonin me cilësi të lartë analizat dhe provat e kërkuara në procesin mësimor si dhe njiheshin konkretisht me realizimin e lërkesave që kishin sipërmarrjet e ndryshme të ndërtimit për analiza dhe prova të cilat përdoren për nevojat e aktivitetit ndërtues. Lidhur me mungesën e disa pajisjeve të dedikuara për këtë PS GVJ u informua për interesimin e vazhdueshëm të institucionit për ti disponuar ato. Në këtë kuadër nëpërmjet një projekti, ku ata ishin fitues, prisnin që këtë vit ti siguronin këto pajisje. <i>Referenca:</i>

	<p>-RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - Anekset 26.1.2.3.4.5.6.7-ambientet - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Ky kriter plotësohet pasi Universiteti Polis vë në dispozicion të programeve të studimit klasa dhe laboratore të paisura me PC dhe programe profesionale edhe për natyrën e PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”. Disa nga këto programe integrohen edhe në pajisjet e laboratorit “Innovation Factory” si një njësi multidisiplinore.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - Anekset 26.1.2.3.4.5.6.7-ambientet - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë Strukturët spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Nga materialet e DVV dhe gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që Universiteti Polis përpos ambienteve për aktivitetet mësimore e kërkimoro-shkencore (auditorë, klasa seminaresh e ushtrimesh, salla konferencash, sallë biblioteke etj) ka nënshkruar edhe 14 marrëveshje me sipërmarrje të ndryshme enkas për kryerjen e praktikave profesionale. Në takimin që pati me studentët GVJ u informua për funksionimin pa probleme të këtyre marrëveshjeve.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis përpos vënjes në dispozicion të mjediseve të tij për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë” garanton, nëpërmjet marrëveshjeve me sipërmarrje ndërtimi, edhe kryerjen me cilësi të praktikave profesionale në kushtet e aktivitetit ndërtues.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3


Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset e posaçme).

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstaton që literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Ky konstatim mbështetet edhe nga studentët, në takimin që GVJ organizoi me to.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse Dokumentet 43-89 Syllabuset - Anekset 26.1.2.3.4.5.6.7-ambientet - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua hollësisht mbi fondin e pasur të bibliotekës, bashkëpunimin e frytshëm edhe me Departamentin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë për të përditësuar dhe pasuruar fondin e saj, masën e përdorimit të literaturës nga studentët, konsiderimin e sugjerimeve e kërkesave të pedagogëve dhe studentëve si dhe dobinë e abonimit nga institucioni tek libraria digjitale JSTOR dhe EBSCO</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Tabelat përmbledhëse - Aneks 29_Literatura-Biblioteka ne funksion te programit - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Ky kriter plotësohet pasi Universiteti Polis ka një bibliotekë me sipërfaqe prej 155 metra katror. Qëllimi i saj është për të mbështetur aktivitetet arsimore, shkencore dhe kërkimore të stafit akademik dhe të studentëve. Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës, GVJ konstaton që ajo përbëhet nga seksione dedikuar programeve të studimit ku, në njërin prej tyre ndodhej edhe literatura për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”. Biblioteka kishte një kapacitet prej 50 vendesh, pjesën e literaturës fizike me rreth 10 000 libra, aksesimin në bibliotekat on-line dhe njesinë administrative të Bibliotekës. Biblioteka garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë të fondit, ofertës dhe ambienteve të saj edhe nga studentët e programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”. Nga biseda me studentët, GVJ u informua që ata ishin të kënaqur me shërbimin e bibliotekës.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Aneks 29_Literatura-Biblioteka ne funksion te programit - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekën e universitetit Polis, GVJ konstaton që ajo ishte e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e</p>

<p>apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>specifikës edhe të programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”. Literatura për këtë PS ishte e specifikuar dhe e sistemuar në mënyrë të tillë që aksesimi të ishte sa më i përshtatshëm si për studentët ashtu edhe për përdorues të tjerë..</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Aneks 29 <i>Literatura-Biblioteka ne funksion te programit</i> - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Ky kriter plotësohet nëpërmjet abonimit që ka bërë institucioni në libraritë dixhitale JSTOR dhe EBSCO. Të gjithë studentët mund të hynin në këto biblioteka duke përdorur e-mailin e tyre të dedikuar me domein @universitetipolis.edu.al. Po ashtu këto biblioteka shfrytëzoheshin edhe nga personeli akademik si burim i rëndësishëm për përgaditjen e leksioneve, dispensave dhe zhvillimin e aktivitetit të tyre kërkimor-shkencor.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Aneks 29 <i>Literatura-Biblioteka ne funksion te programit</i> - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që biblioteka është e paisur me programe kompjuterike dhe teknologji të tjera, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët që e frekuentojnë atë.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Aneks 29 <i>Literatura-Biblioteka ne funksion te programit</i> - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Në universitetin Polis biblioteka qëndron e hapur prej orës 08.30 deri në orën 16.30. Për studentët e programeve master pra edhe për ata të PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë” biblioteka shfrytëzohej të shtunën dhe të dielën në orarin 09.00-17.00. Gjatë takimit me studentët ata pohuan për GVJ se ishin të kënaqur me shërbimet e bibliotekës.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Aneks 29 <i>Literatura-Biblioteka ne funksion te programit</i> - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga</p>	<p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët si dhe gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ u informua për cilësinë e fondit fizik dhe fondit online të saj. Ata pohuan që fondi përditësohej në mënyrë të vazhdueshme dhe se përdorimi i tij ishte efektiv në plotësimin e nevojave, kryesisht me literaturë profesionale (libra dhe revista). Sugjerimet dhe kërkesat e tyre përcilleshin edhe në department edhe direct tek personeli i bibliotekës dhe merreshin në kondisera të prej tyre me përparësi.</p> <p><i>Referenca:</i></p>



personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>-Aneks 29_Literatura-Biblioteka ne funksion te programit</p> <p>- https://www.universitetipolis.edu.al/</p>			
Konkluzione	<p>Në shqyrtimin përmbljedhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që programi i studimit "Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë" përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme etj).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Universiteti Polis qysh prej vitit 2019, disponon sistemin e menaxhimit në platformën "Pitagora". Nëpërmjet këtij sistemi administrohet i gjithë informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim. Çdo student ka llogarinë e tij të dedikuar në këtë system. Në takimin me studentët, GVJ u informua që ky system funksionon në mënyrë të pandërprerë dhe i plotëson të gjitha kërkesat për shërbimet që u nevoiten atyre.</p> <p>Referenca:</p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://polis.pitagora.rash.al/login</p> <p>- https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Sistemi "Pitagora" administrojnë edhe informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit "Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë". Në takimin me personelin akademik, GVJ u informua që ky system funksionon në mënyrë të pandërprerë dhe i plotëson të gjitha kërkesat për shërbimet që u nevoiten atyre.</p> <p>Referenca:</p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p>



	<p>- https://polis.pitagora.rash.al/login - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Duke qenë se sistemi "Pitagora" shërben si sistem i menaxhimit të brendshëm në universitetin Polis, ai siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente edhe për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit "Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë".</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - https://polis.pitagora.rash.al/login - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit "Pitagora" është i instaluar në platformën Google në faqen https://polis.pitagora.rash.al/login, arrihet nëpërmjet adresës së dedikuar për çdo individ dhe përmban module insertimi, leximi dhe editimi, të cilat mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - https://polis.pitagora.rash.al/login - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit "Pitagora" garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Informacionet jepen nëpërmjet domenit https://www.universitetipolis.edu.al/, i cili i afishon ato në rubrika të posaçme.</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - https://polis.pitagora.rash.al/login - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Universiteti Polis ka domenin e tij në internet, platforma google, i cili arrihet në adresën https://www.universitetipolis.edu.al/. Në këtë adresë gjenden të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në rang institucioni, njësisish kryesore, njësisish përgjegjëse, programesh studimi, partnerët strategjikë etj. GVJ e vizitoi këtë faqe dhe konstaton plotësimin e kriterit.</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - https://polis.pitagora.rash.al/login - https://www.universitetipolis.edu.al/ Annex 37- ICTC Office Services.pdf</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit institucional Pitagora dhe e vë atë në dispozicion të</p>

	<i>administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Referuar DVV dhe vizitës në Universitetin Polis, GVJ konstaton që ky institucion harton një raport financiar të kostove dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshëm për mbarëvajtjen e njërive përbërse të tij, ku përfshihet edhe Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinjerisë si njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit “Msc në inxhinieri ndërtimi me profil strukturë”. Raporti financiar dhe plani mbështetës hartohen çdo vit duke marrë në konsideratë të gjitha shpenzimet e vitit të kaluar dhe të gjitha nevojat e kërkesave për vitin në vazhdim. Procedura që ndiqet është konform dispozitave ligjore që përcaktojnë raportimet mbi shpenzimet, të ardhurat dhe planifikimin e buxhetit. Duke marrë në konsideratë përvojën e krijuar nga ky institucion, buxhetin e pavarur të tij si dhe produktet e realizuara në vite, GVJ konstaton plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i> - R/VB - Shënime nga vizita në Institucion - - Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të</p>	<p>Burimet e financimit në universitetin Polis janë: tarifat e studentëve (kryesisht), grantet për kërkim dhe kontratat si dhe të ardhura të klasifikuara si “të tjera”. Në përqindje mesatare për tre vitet e fundit vlera e tyre është respektivisht 9.5%, 88% dhe 2.5%. Të gjitha fondet e siguruara shërbejnë për financimin e burimeve njerëzore akademike e administrative në shërbim të realizimit të programeve, burimeve infrastrukturore logjistike dhe didaktike si dhe investime afatgjata ku hyjnë paisje për klasa, laboratore si dhe investime afatgjata.</p> <p>Strukturë e shpenzimeve në univeristetin Polis për 3 vitet e fundit ka qenë:</p> <p>Shpenzime për burime njerzore, akademike dhe administrative që i shërbejnë PS 67%.</p> <p>Shpenzime operative, mbështetje për procesin mësimor, pasurimin e bibliotekës, përdorimin e biblioteks dixhitale, mirmbajtje etj 28%</p>

<p>programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Shpenzime ku përfshihen investimet në paisje, orendi, kompletim klasa dhe laboratore 5%.</p> <p>Duke analizuar strukturën e burimeve të të ardhurave dhe atë të shpenzimeve si dhe numrin mesatar të studentëve të regjistruar në këtë PS për tre vitet e fundit (27 studentë), GVJ gjykon që institucioni dhe njësitë përbërse të tij duhet të përpiqen të shtojnë peshën e të ardhurave nga grantet për kërkim dhe kontratat si dhe të zërit “të tjera” në mënyrë që të zvogëlohen të ardhurat nga tarifat e studentëve. Po ashtu duhet të forcohet më tej puna për rritjen e numrit të rekrutimeve.</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - - Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që pasqyrat financiare të Universitetit Polis auditohen nga një kompani e huaj. Raportet e auditimit konfirmojnë vërtetësinë dhe pasqyrimin e drejtë të informacionit financiar. Institucioni gjykon që burimet financiare janë të mjaftueshme dhe të shpërndara mirë në zërat e shpenzimeve për të përmbushur kërkesat dhe nevojat e aktivitetit mësimor e shkencor në PS “Msc në inxhinieri ndërtimi me profil strukturë.</p> <p>GVJ gjykon plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - - Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Gjatë vizitës në universitetin Polis, GVJ u informua që ky institucion raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse, Departamentin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, për programin e studimit “Msc në inxhinieri ndërtimi me profil strukturë”, mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. GVJ mësoi gjithashtu që institucioni ka hartuar një strategji për të rritur më tej të ardhurat dytësore në mënyrë që të ulët riskun e “goditjeve” nga rënjet e përkohshme të numrit të studentëve, nëpërmjet rritjes së pjesmarrjes në projektet e financuara nga donatorë si EU, IIK, SIDA etj.</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - - Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ u informua që universiteti Polis përpara fillimit të çdo viti, përveç buxhetit vjetor harton edhe një parashikim financiar me afate 3 dhe 5 vjeçare. Bazuar në këto parashikime ai bën edhe përditësim vjetor për të koregjuar parashikimet në mënyrë që të gjenden burimet e nevojshme të financimit. Ai e bazon qëndrueshmërinë financiare në tre shtylla kryesore:</p>



<p>të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja dhe përmirësimi i reputacionit për të rritur rekrutimet • Optimizimi i burimeve njerzore, infrastrukturore e profesionale për të ulur kostot dhe rritur performancën • Diversifikimin e programeve të studimit për të krijuar një portofol që siguron uljen e riskut nga ulja e numrit të përgjithshëm të studentëve si dhe shtrirjen përtej aktivitetit akademik të burimeve financiare si rritja e pjesmarrjes në projekte e grante, lidhje më të forta me biznesin për të fituar më shumë mbështetje prej tij etj. <p>Në kontekstin e PS “Msc në inxhinieri ndërtimi me profil strukturë” GVJ sugjeron përshejtimin e ritmeve në këto drejtime për të ulur sa më shumë riskun e mosvazhdimin të këtij programi.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - - Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis në stadin aktual garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. GVJ gjykon që në perspektivë, me zvogëlimin e numrit të studentëve, tarifat e studimit ose mund të bëhen të papërballueshme ose jo interesante në raport me konkurrencën prandaj GVJ sugjeron diversifikimin e mëtejshëm të burimeve finaciare në mënyrë që të ardhurat nga tarifat e studentëve të mbeten të përballueshme prej tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Referuar DVV, RVB dhe takimeve gjatë vizitave në institucion, GVJ konstaton që Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Hapja e programeve të studimeve bazohet në ligjin nr 80/2015 dhe duke konsideruar specifikat e sejcilit program të hartuara nga departamenti përkatës> Programi miratohet nga senati akademik. Universiteti Polis shpall në adresën e tij në internet programet e akredituara. Rekrutimi i studentëve në këto programe bëhet bazuar në aktet ligjore të universitetit. GVJ konsultoi “Rregulloren didaktike” dhe konstaton që kreu IV i kësaj rregullorje përmban të gjitha procedurat e pranimit të studentëve ku përfshihen dispozitat e përgjithshme, aplikimi, transferimi deri në diplomim. Të gjitha këto procedura publikohen për tu vënë në dispozicion të të interesuarve. Për studentët, në veçanti, njohja me procedurat fillon me javën orientuese. Në këtë kohë ai “miqësohet” edhe me ambientet mësimore si dhe shërbimet që ofron veçmas institucioni. E gjithë ecuria e procesit të diplomimit për çdo student dokumentohet dhe ruhet në institucion, pa afat. Në takimin me studentët GVJ u informua se ata i njihnin këto procedura dhe konfirmonin që zbatimin e tyre ishte në dobi të gjithë aktivitetit të tyre në institucion.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 1 _Statuti i Universitetit POLIS - Aneks 4 _Rregullore Didaktike - Aneks 6 _Rregullore e programit të studimit - Aneks 7 _Rregullore Diplomimi Msc_ING - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Jo vetëm në dokumentacionin e konsultuar por edhe në takimet në institucion, kryesisht gjatë takimit me studentët, GVJ konstaton që politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”. Si të drejtat ashtu edhe detyrimet ishin të njohura nga studentët edhe nëpërmjet dokumentacionit të publikuar nga institucioni, edhe nga veprimtaria konkrete që zhvillohej gjatë kohës së studimeve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të konsulencës nga zyrat përkatëse (ZMSKK).</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion

	<p>- Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING Aneks 35_Rregullore ZMSKK - Aneks 34_Guida e Sudentit - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me Strukturët e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Referuar DVV, RVB dhe vizitës në institucion GVJ u informua që institucioni bazuar në kërkesat e MAS, rregulloren didaktike, rregulloren e programit “Msc në inxhinieri ndërtimi me profil strukturë”, me propozim të departamentit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, miratim të fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit dhe vendim të Senatit Akademik, përcakton kriteret e pranimit dhe kuotat e pranimit për kandidatët që duan të studiojnë në PS “Msc në Inxhinieri ndërtimi me profil strukturë”. Universiteti disponon gjithë infrastrukturën e nevojshme për të transmetuar tek kandidatët informacionin e duhur lidhur me planin mësimor, lëndët/modulet, syllabuset etj duke filluar me broshura, fletëpalosje, ZMSKK, faqen zyrtare të institucionit në adresën www.universitetipolis.edu.al, rrjeteve sociale etj.</p> <p>Në takimin me studentët, GVJ konstaton që ata janë njohur me kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe në plotësim të tyre kanë filluar studimet në PS “Msc në inxhinieri ndërtimi me profil strukturë”</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 34_Guida e Sudentit Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Lidhur me plotësimin e këtij kriteri GVJ konstaton që procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve në “Msc në inxhinieri ndërtimi me profil strukturë” janë përcaktuar në Rregulloren e Programit, faqen zyrtare të institucionit, rrjetet sociale të universitetit etj. Ata u jepen studentëve edhe nëpërmjet takimeve që kërkojnë ata, kryesisht tek ZMSKK.</p> <p>Në zbatim të kërkesave dhe dispozitave ligjore Universiteti Polis u ofron studentëve mundësinë për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve të të njejtit cikël studimi. Vendimin për njohjen e plotë ose të pjeshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet e merr Komisioni i Ekuivalentimit të Krediteve ngritur nga njësi bazë (Departamenti) në përputhje me aktet nënligjore të institucionit. Gjatë takimit me studentët GVJ u informua mbi transferimin e studimeve të 3 studentëve të ardhur nga diploma Bch e UPT në PS “Msc në inxhinieri ndërtimi me profil strukturë”.</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike</p>

	<p>- Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 34_Guida e Sudentit Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar dokumentacionit të konsultuar, informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe publikimeve në faqen zyrtare https://www.universitetipolis.edu.al/, GVJ konstaton plotësimin e këtij kriteri. Të gjitha kërkesat referohen në dispozitat ligjore dhe interesat e institucionit për të tërhequr kontigjente sa më cilësorë. Për kandidatët e pranuar shërben Zyra e pranimeve, e cila u jep atyre informacione të detajuara për universitetin dhe njësitë e tij si dhe për programin e studimit përkatës.</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 34_Guida e Sudentit Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.</p>	<p>Për të siguruar një përzgjedhje sa më të qëlluar të kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara, GVJ u informua që Universiteti Polis, nëpërmjet ZMSKK dhe Zyrës së Projekteve është partner në projektin IDEA, që ka për objekt përmirësimin e aksesit, krijimin e kushteve të mësimi dhe zhvillimin e mundësive të punësimit për këtë kategori kandidatësh. Po ashtu Institucioni ka krijuar edhe një staf që vleron kapërcimin e pengesave që lidhen me këto kandidatë. Në kuadrin e një projekti të mbështetur nga Erasmus+ pritet hartimi i një rregulloreje si bazë për lehtësimin e proceseve të akomodimit të kësaj kategorie studentësh.</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 34_Guida e Sudentit Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Për kandidatët që vijnë nga shtetet e tjera dhe kërkojnë të përfshihen në PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil Strukturë”, hartohen dhe publikohen përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Publikimi i këtyre kriterëve bëhet në institucion (në vende të dukshme brenda korpusit), në faqen zyrtare të universitetit, lajmërimeve të dedikuara me e-mail si dhe mediat sociale.</p>

	<p>GVJ konsultoi faqen zyrtare të universitetit dhe gjeti aty informacionet e kërkuara.</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 Rregullore Didaktike - Aneks 6 Rregullore e programit të studimit - Aneks 7 Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 34 Guida e Sudentit Aneks 35 Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Referua DVV, RVB dhe vizitës në institucion GVJ konstaton që në Universitetin Polis janë hartuar kritere lidhur me kandidatët që vijnë nga shtresa të marginalizuara të shoqërisë. Për të përkrahur këta studentë por edhe për të inkurajuar studentët e shkëlqyer institucioni ndjek politika lehtësuese financiare të cilat konsistojnë në subvencionimin e programeve të veçanta dhe reduktimin e tarifës së shkollimit. Për plotësimin e këtij kriteri GVJ konsultoi dhe faqen zyrtare online të universitetit ku në zërin “Bursa studimi” jepen kategoritë që përfitojnë dhe kriteret që duhet të plotësojnë.</p> <p>Kategoritë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Studentë Ekselentë; 2. Studentë nga e njëjta familje; 3. Studentë nga shtresat sociale në nevojë <p>Kriteret e fitimit të bursës:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Studentët e shkëlqyer <ul style="list-style-type: none"> • që kanë mesatare (VKM) mbi 9 (nëntë) – dërguar nga AKP dhe në përputhje me mesataren e shënuar në diplomën e shkollës së mesme; • që kanë marrë në testin e përgjithshëm, të organizuar pranë U_POLIS, minimumi 70 % (shtatëdhjetë për qind) të pikëve totale. • që dallohen si talente në konkurime dhe evente garuese të Polis ose të tjera kombëtare/ndërkombëtare duke e provuar këtë me dokumentacion. b) Studentët nga e njëjta familje: <p>Motër – Vëlla; Motër – Motër; Vëlla – Vëlla; Prind – Fëmijë të cilët janë në të njëjtën certifikatë familjare; dhe Burrë – Grua;</p> c) Shtresat sociale në nevojë: <p>Fëmijët jetim; Fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës;</p>

	<p>Fëmijë nga komuniteti rom;</p> <p>Fëmijë nga familje në pamundësi ekonomike;</p> <p>Studentë që konsiderohen invalid, sipas parashikimeve ligjore; etj.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- Aneks 4_Rregullore Didaktike</p> <p>- Aneks 34_Guida e Sudentit</p> <p>Aneks 35_Rregullore ZMSKK</p> <p>- https://www.universitetipolis.edu.al/</p>			
Konkluzione	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve si dhe diplomimin.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Për plotësimin e këtij kriteri, GVJ konsultoi fillimisht “Rregulloren e Programit”, “Rregulloren Didaktike”, “Rregulloren e diplomimit” dhe “Guidën e studentit” nga ku konstaton që ata japin një informacion të plotë e të qartë mbi kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Qysh në momentin e fillimit të vitit akademik, në javën e parë mbahet ceremonia e hapjes ku studentëve të çdo programi studimi u jepet informacion i plotë për të gjitha programet. Në takimim me studentët GVJ u informua për disponimin nga ana e tyre e informacionit të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Këtë shërbim ata e marrin edhe nga interneti, ku gjendet i përfshirë në sistemin interaktiv të universitetit “Pitagora”.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- Aneks 4_Rregullore Didaktike</p> <p>- Aneks 6_Rregullore e programit të studimit</p> <p>- Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING</p> <p>- Aneks 34_Guida e Sudentit</p> <p>Aneks 35_Rregullore ZMSKK</p> <p>- https://www.universitetipolis.edu.al/</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në dokumentacionin bazë të institucionit jepen informacionet që lidhen me kriteret dhe procedurat e njohjes të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Këto informacione merren edhe tek zyrat përkatëse të institucionit si Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës apo në faqen zyrtare të universitetit. Në takimin me studentët GVJ u informua për procedurën e ndjekur e cila konsistonte në plotësimin e krediteve sipas kartës së Bolonjës ku institucioni i pajiste studentët me një program të veçantë për frekuentimin e lëndëve/moduleve dhe shlyerjen e tyre në kohë.</p> <p><i>Referenca:</i> - R/VB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 34_Guida e Studentit Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informacioni për studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive jepen qysh në ditët e javës së parë. Po ashtu në “Guidën e studentit” ata gjejnë informacionet e kërkuara për këtë rubrikë. Më tej informacionet merren edhe në faqen zyrtare të institucionit në internet në adresën https://www.universitetipolis.edu.al duke kërkuar profilin përkatës të studimit, në platformën “Pitagora” dhe nëpërmjet postës së dedikuar elektronike. GVJ i konsultoi këto burime informacioni dhe në takimin me studentët konfirmoi që ata kishin informacionin e duhur lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive.</p> <p><i>Referenca:</i> - R/VB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 34_Guida e Studentit Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Për plotësimin e këtij kriteri GVJ shqyrtoi “Rregulloren e Diplomimit” në të cilën përcaktohet procedura e diplomimit që nga momenti i aplikimit për temën, miratimi i temës dhe pedagogut udhëheqës nga departamenti, procesi i shkrimit të tezës deri në formatimin specifik të punimit, dorëzimit, vlerësimit dhe mbrojtjes. Në takimin me studentët GVJ u informua për procedimin konkret të tyre gjatë punës për mbrojtjen e tezës së diplomës.</p> <p><i>Referenca:</i> - R/VB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit</p>

	<p>- Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 34_Guida e Sudentit Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Në universitetin Polis ky kriter plotësohet duke organizuar për studentët ditët e hapura të dedikuar për çdo program studimi në mënyrë që studentët të njihen më nga afër me infrastrukturën e universitetit, ambientet laboratorike, kurrikulën e programit, akreditimin institucional etj. Po ashtu studentët paisen me guidën e studentit si dhe u rekomandohen rubrikat përkatëse të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Universiteti Polis merr pjesë edhe në panairët informuese të organizuara në qytetet e ndryshme të vendit apo të organizuara nga bashkia Tiranë, ku përveç përfaqësuesve të zyrës së pranimeve është i pranishëm edhe një përfaqësues i personelit akademik, për të informuar mbi ofertat mësimore të universitetit.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 34_Guida e Sudentit Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Në shqyrtimin përmblendhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti Polis vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Referuar Rregullores së Programit të Studimi “Msc në inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë” GVJ konstaton që aty përcaktohen kushtet për aplikim dhe pranim në këtë program studimi. Informimi për studentët nis qysh në fillim të vitit akademik ku në një seksion të veçantë prezantohet mënyra e organizimit të PS, kohëzgjatja, ndarja e lëndëve/moduleve, tipet e veprimtarive formuese, koncepti i krediteve ECTS, format e mësimit teorik e praktik, zhvillimi i mësimi, frekuentimi, përmbajtja e syllabuseve etj. Këtë informacion studentët e gjejnë edhe “Rregulloren Didaktike”, “Guidën e studentit” si dhe në faqen zyrtare të institucionit. Gjatë takimit me studentët, GVJ konstaton që ata i kanë të gjitha informacionet e kërkuara.</p>

	<p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 34_Guida e Sudentit Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët njihen me planin mësimor të profilit të tyre, syllabuset e çdo lënde, veprimtaritë përkatëse mësimore (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, detyra) dhe procedurat e vlersimit të njohurive. Këto informacione u transmetohen atyre në mënyrë të vazhdueshme qysh me fillimin e programit të studimeve e deri në diplomim. Sipas profilit të tyre, studentët udhëzohen ti gjejnë këto informacione edhe në faqen zyrtare të institucionit. Gjatë takimit me studentët GVJ konstaton që ata i zotërojnë të gjitha informacionet e kërkuara.</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 34_Guida e Sudentit Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nëpërmjet Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) të studentët informohen mbi mundësitë e punësimit si dhe mbështeten institucionalisht për orientimin drejt tregut të punës. Uiversiteti Polis është edhe partner në platformën “Gradua”, e cila është ngritur në kuadër të projektit Erasmus+ dhe synon të mbështesë universitetet dhe studentët shqiptarë të konsultojnë një sistem interaktiv të dhënash dhe një model që përputhet me kërkesën dhe ofertën e punësimit të të diplomuarve. Platforma mundëson:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorimin e lirë të saj duke krijuar një CV profesionale (me kalimin e kohës kjo CV pasurohet me aktivitet që kryen i diplomuari) e cila është e dukshme për kompanitë dhe institucionet e interesuara. • Qasjen pa vështirësi në informacionin për mundësitë e punës, praktikave profesionale, kurseve të trajnive që ofrohen nga kompani dhe biznese të ndryshme. • Aplikim direkt për vende pune nga antarët e platformës <p>Sipas statistikave të institucionit për punësimin rezulton që rreth 95% e studentëve të diplomuar janë punësuar në përputhje me diplomën dhe vetëm rreth 5 % janë punësuar jo në përputhje me diplomën, ndërkohë që shkalla e përgjithshme e punësimit është rreth 88%. Këto tregues dëshmojnë kërkesën e lartë që ka tregu për studentët që përfundojnë studimet në PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”.</p>

	<p><i>Referenca:</i> -<i>RVB</i> -<i>Shënime nga vizita në Institucion</i> - <i>Aneks 4_Rregullore Didaktike</i> - <i>Aneks 6_Rregullore e programit të studimit</i> - <i>Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING</i> -<i>Aneksi 30 Tabelat përmbledhëse</i> - <i>Aneks 34_Guida e Sudentit</i> <i>Aneks 35_Rregullore ZMSKK</i> - <i>https://www.universitetipolis.edu.al/</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Të gjithë studentët e PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë” kanë akses në sistemin interaktiv të universitetit “Pitagora”, ku gjejnë të gjitha informacionet për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, si dhe logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Po ashtu, në dispozicion të tyre janë edhe zyrat përkatëse në institucion të cilat i ofrojnë këto shërbime sa herë u kërkohen nga të interesuarit.</p> <p><i>Referenca:</i> -<i>RVB</i> -<i>Shënime nga vizita në Institucion</i> - <i>Aneks 19_Manualet e Perdorimit PITAGORA</i> - <i>Aneks 34_Guida e Sudentit</i> <i>Aneks 35_Rregullore ZMSKK</i> - <i>https://www.universitetipolis.edu.al/</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Ky kriter plotësohet me aksesin që kanë të gjithë studentët e PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”. në sistemin “Pitagora”, si dhe në faqen zyrtare të universitetit Polis.</p> <p><i>Referenca:</i> -<i>RVB</i> -<i>Shënime nga vizita në Institucion</i> - <i>Aneks 19_Manualet e Perdorimit PITAGORA</i> - <i>Aneks 34_Guida e Sudentit</i> <i>Aneks 35_Rregullore ZMSKK</i> - <i>https://www.universitetipolis.edu.al/</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriteve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Strukturë”.</i></p> <p><i>Informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.

Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konsultoi tre regjistrat që duhet të disponohen në këtë sekretari sipas Udhezimit Nr.16, date 08.07.2019 për “Pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studenteve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e leshimit të diplomave dhe certifikatave”. Nga shqyrtimi i tyre, GVJ konstaton që Universiteti Polis disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”.

Referenca:

- RVB
- Shënime nga vizita në Institucion
- Aneksi 30 Tabelat përmbledhëse
- Aneks 34_Guida e Studentit
- <https://www.universitetipolis.edu.al/>

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Plotësimi i këtij kriteri dëshmohet nga shqyrtimi i regjistrave që ndodhen në sekretarinë mësimore. GVJ konstaton që regjistrat plotësohen rregullisht, me shënime të qarta, pa korregjime dhe konform udhëzimit Nr.16, date 08.07.2019. Referuar të dhënave që morëm në sekretarinë mësimore numri i studentëve për programin e studimit “Msc Inxhinieri Ndërtimi me profil Strukturë është si vijon:

Viti akademik	Te regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Të larguar	Të diplomuar
2019-2020	20	1		16
2020-2021	23		1	12
2021-2022	26	1	2	17
2022-2023	28	2		

Referenca:

- RVB
- Shënime nga vizita në Institucion
- Aneksi 30 Tabelat përmbledhëse
- <https://www.universitetipolis.edu.al/>

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe


GVJ konsultoi sistemin e interaktiv të informacionit në platformën “Pitagora” që menaxhohet nga sekretaria mësimore dhe konstaton që të dhënat për studentët menaxhohen të plota, të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Çdo student kishte adresë të dedikuar për këtë sistem.

<p>lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 19_Manualet e Perdoritimit PITAGORA -Aneksi 30 Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>																																																																	
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Plotësimi i këtij kriteri realizohet nëpërmjet akteve të brendshme organizative për mënyrën e kontrollit të gjendjes dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtaritë përkatëse të tyre. Për këtë qëllim, me vendim të Rektorit, në fund të çdo viti akademik ngrihet një grup ad hoc i cili ka si objekt kontrollin e saktësisë të mbajtjes së informacionit në të gjitha njësitë administrative duke hartuar një raport analitik mbi situatën dhe përmirësimet e nevojshme që duhet të ndërmerren për rritjen e cilësisë së ofruar në shërbimet akademike përkatësisht administrative. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi realizimin e kësaj procedure.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 8_Rregullore NJBSC - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>																																																																	
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u interesua për statistikave që disponohen mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve në programin mësimor “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë” dhe referuar statistikave edhe në tabelën e mëposhtme konstatohet disponimi i evidentimit. Po ashtu në shqyrtim të dokumentacionit të DVV si dhe gjatë vizitave në Sekretarinë Mësimore, ZMSKK dhe Alumnit GVJ mësoi që shkalla e punësimit të studentëve të këtij PS në përputhje me diplomën është rreth 95% ndërkohë që shkalla e përgjithshme e punësimit është 88%. Këto të dhëna përmbaheshin në raportet analitike së toku me masat e duhura për përmirësimin e treguesve.</p> <table border="1" data-bbox="612 1435 1362 1720"> <thead> <tr> <th>Programet e studimit që ofrohen IAL</th> <th>Viti Akademik</th> <th>Nr. i studentëve të regjistruar për herë të mirë</th> <th>Mesatarja në Hyrje</th> <th>Nr. i studentëve të Transferuar</th> <th>Nr. i studentëve të larguar (sipas Brazave)</th> <th>Të Diplomuar (Sipas Brazave)</th> <th>Mesatarja në Dalje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="8">Msc në Inxhinieri Ndërtimi</td> <td>Viti Akademik 2016-2017</td> <td>17</td> <td>7.65</td> <td></td> <td></td> <td>12</td> <td>7.6</td> </tr> <tr> <td>Viti Akademik 2017-2018</td> <td>32</td> <td>6.52</td> <td>7</td> <td>1</td> <td>30</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>Viti Akademik 2018-2019</td> <td>40</td> <td>6.58</td> <td>6</td> <td>4</td> <td>34</td> <td>8.3</td> </tr> <tr> <td>Viti Akademik 2019-2020</td> <td>20</td> <td>6.75</td> <td>1</td> <td></td> <td>16</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>Viti Akademik 2020-2021</td> <td>23</td> <td>6.98</td> <td></td> <td>2</td> <td>12</td> <td>8.1</td> </tr> <tr> <td>Viti Akademik 2021-2022</td> <td>24</td> <td>7.33</td> <td></td> <td></td> <td>15</td> <td>7.8</td> </tr> <tr> <td>Viti Akademik 2022-2023</td> <td>29</td> <td>7.06</td> <td></td> <td></td> <td>2</td> <td>nuk janë diplomuar akoma</td> </tr> <tr> <td>Viti Akademik 2023-2024</td> <td>28</td> <td>7.17</td> <td>2</td> <td></td> <td></td> <td>nuk janë diplomuar akoma</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 8_Rregullore NJBSC</p>	Programet e studimit që ofrohen IAL	Viti Akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të mirë	Mesatarja në Hyrje	Nr. i studentëve të Transferuar	Nr. i studentëve të larguar (sipas Brazave)	Të Diplomuar (Sipas Brazave)	Mesatarja në Dalje	Msc në Inxhinieri Ndërtimi	Viti Akademik 2016-2017	17	7.65			12	7.6	Viti Akademik 2017-2018	32	6.52	7	1	30	8	Viti Akademik 2018-2019	40	6.58	6	4	34	8.3	Viti Akademik 2019-2020	20	6.75	1		16	8	Viti Akademik 2020-2021	23	6.98		2	12	8.1	Viti Akademik 2021-2022	24	7.33			15	7.8	Viti Akademik 2022-2023	29	7.06			2	nuk janë diplomuar akoma	Viti Akademik 2023-2024	28	7.17	2			nuk janë diplomuar akoma
Programet e studimit që ofrohen IAL	Viti Akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të mirë	Mesatarja në Hyrje	Nr. i studentëve të Transferuar	Nr. i studentëve të larguar (sipas Brazave)	Të Diplomuar (Sipas Brazave)	Mesatarja në Dalje																																																											
Msc në Inxhinieri Ndërtimi	Viti Akademik 2016-2017	17	7.65			12	7.6																																																											
	Viti Akademik 2017-2018	32	6.52	7	1	30	8																																																											
	Viti Akademik 2018-2019	40	6.58	6	4	34	8.3																																																											
	Viti Akademik 2019-2020	20	6.75	1		16	8																																																											
	Viti Akademik 2020-2021	23	6.98		2	12	8.1																																																											
	Viti Akademik 2021-2022	24	7.33			15	7.8																																																											
	Viti Akademik 2022-2023	29	7.06			2	nuk janë diplomuar akoma																																																											
	Viti Akademik 2023-2024	28	7.17	2			nuk janë diplomuar akoma																																																											

	<p>-Aneksi 30 Tabelat përmbledhëse - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>			
Konkluzione	<p>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti Polis mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit "Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil Strukturë", nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Në shqyrtim të DVV, GVJ konsultoi të gjitha dokumentat që lidhen me përfshirjen dhe angazhimin e studentëve, përkatësisht përfaqësuesve të tyre, në organet vendimmarrëse e këshilluese mbështetur me akte ligjore dhe rregullatore të Universitetit Polis. Në Statutin e institucionit thuhet që studentët janë pjesë e organeve vendimmarrëse të universitetit, duke përmbushur kështu një detyrim ligjor që rrjedh nga ligji për arsimin e lartë 80/2015. Po ashtu në rregulloren e PS "Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil Strukturë" tek neni 8 është përcaktuar që: Studenti ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në Përfaqësinë Studentore sipas rregullave të kësaj të fundit. Në zbatim të këtyre detyrimeve, në Universitetin Polis funksionojnë "Senati studentor" si dhe "Klubet Studentore". Në faqen zyrtare të Universitetit Polis statusi i senatit studentor jepet si vijon:</p> <p>Senati Studentor" është pjesë e strukturës të Universitetit POLIS që ushtron veprimtarinë e tij në koordinim me organet drejtuese të Universitetit. Qëllimi kryesor i Senatit Studentor është angazhimi dhe aktivizimi i studentëve në aktivitete që lidhen ngushtë me veprimtarinë akademike, por dhe me të tjera që promovojnë jetën aktive dhe sociale të studentëve. Senati ka Statutin e tij, është autonom, mbështetet nga Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës dhe përfaqëson zërin e studentëve në unanimitet. U_POLIS ka një Përfaqësues Studenti të zgjedhur përmes një procesi demokratik nga komuniteti bazuar në rregulloren e tij. Çdo studim/program ka përfaqësuesin/ët e tij, duke përmbushur proporcionalitetin përfaqësues të 1 Përfaqësuesi për 30 studentë. Ndërsa për klubet studentore thuhet: Në POLIS funksionojnë "Klubet" e pavarura por që ndajnë së bashku: vlerat, misionin dhe filozofinë e përbashkët të U_POLIS. Në vijim jepet edhe fusha e aktivitetit të tyre. Referuar këtyre angazhimeve të studentëve GVJ konstaon plotësimin e këtij kriteri.</p>

	<p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 8_Rregullore NJBSC - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në takimin me studentët, GVJ u interesua të informohej për mendimin që kishin ata lidhur me “forcën” e zërit të tyre në organet ku ata përfaqësoheshin dhe konstaton që vlersimi i tyre ishte i lartë. Pra, ata ndjeheshin të përfaqësuar plotësisht në vendimmarrjen, këshillimin apo vlerësimin mbi procesin akademik.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 8_Rregullore NJBSC - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Në takimin me studentët, GVJ u interesua të informohej për rolin e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Në përgjigje të këtij interesimi, studentët konfirmuan angazhimin e tyre në rishikimin e planit mësimor dhe konsiderimin e sugjerimeve të tyre për ndryshime kryesisht në praktikën profesionale dhe procedurën e vlersimeve. Në diskutimet me pedagogët e lëndëve, përkatësisht moduleve, ata kishin pasuruar modulet duke përfshirë trajtime të veçanta si psh përvojat në ndërtim pas tërmetit të 26 nëntorit 2019.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 8_Rregullore NJBSC - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e</p>	<p>Në takimin me studentët, GVJ u interesua të informohej sa konsiderohej dhënia e mendimit të tyre për barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, ankimimit të rezultatit si dhe rishikimit e reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Në përgjigje të këtij interesimi ata u përgjigjen për konsiderimin e plotë të të gjithë problematikave që ngrinin lidhur me</p>



institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>vlersimin. Ata pohuan njohjen dhe ndjekjen e të gjitha procedurave që kanë të bëjnë me vlersimin.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 8_Rregullore NJBSC - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/ 			
Konkluzione	<p>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Procedurat dhe njësitë e posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në Universitetin Polis janë ngritur e funksionojnë mbi bazën e Statutit të Universitetit, “Rregullores së Përgjithshme, “Rregullores didaktike” si dhe dispozitave të tjera ligjore në zbatim të përcaktimeve të ligjit 80/2015. Njësia e posaçme që merrret me informimin e studentëve dhe mbështetjen e tyre është Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK). Në takimim me studentët GVJ u informua që ata ishin mjaft të kënaqur me shërbimet e kësaj njësie. Po ashtu Senati Studentor ka për detyrë respektivisht të përfaqësojnë studentët dhe të përcjellë në organet kompetente të institucionit problemet që i shqetësojnë dhe të marrin përsipër zgjidhjen e tyre. Ata i informojnë studentët për përcjelljen dhe realizimin e kërkesave të tyre.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 8_Rregullore NJBSC - Aneks 34_Guida e Studentit - Aneks 35_Rregullore ZMSKK

<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>- https://www.universitetipolis.edu.al/</p> <p>Sistemi i posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit në Universitetin Polis lidhet më së pari me aksesin në Sistemin Interaktiv “Pitagora”. Në këtë sistem çdo student ka adresë të dedikuar, e cila funksionon mbi bazën e adresës së E-Mail-it në domenin https://www.universitetipolis.edu.al/ Në adresën e E-Mail-it dhe në rubrikat e sistemit “Pitagora” studenti informohet, merr këshilla, ndjek përparimin e tij dhe asistohet për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Po ashtu në këtë sistem përfshihen edhe ZMSKK, sekretaria mësimore, koordinatorët e programeve të studimit etj. Në takimin me studentët GVJ konstaton se ata ishin të kënaqur me funksionimin e sistemit për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 8_Rregullore NJBSC - Aneks 34_Guida e Studentit - Aneks 35_Rregullore ZMSKK <p>- https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë vizitës në Universitetin Polis, GVJ u takua dhe me përfaqësues të Zyrës së Mbështetjes së Studentëve e Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) për tu njohur konkretisht me aktivitetin e saj në dobi të informimit dhe orientimit të studentëve, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. GVJ konstaton se shërbimet e kësaj zyre janë efektive dhe me interes për studentët.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 8_Rregullore NJBSC - Aneks 34_Guida e Studentit - Aneks 35_Rregullore ZMSKK <p>- https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve</p>	<p>GVJ konsultoi statistikën e Zyrës së Mbështetjes së Studentëve e Këshillimit të Karrierës dhe mësoi që rreth 95% e studentëve të diplomuar janë punësuar në përputhje me diplomën dhe vetëm rreth 5% janë punësuar jo në përputhje me diplomën, ndërkohë që shkalla e përgjithshme e punësimit është rreth 88%. Këto tregues u vihen në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>

dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	dhe dëshmojnë kërkesën e lartë që ka tregu për studentët që përfundojnë studimet në PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil Strukturë”.			
	<i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 34_Guida e Studentit - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbljedhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Duke shqyrtuar DVV, RVB dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Universiteti Polis, nëpërmjet NjBSC, aktiviteti i së cilës disiplinohet e funksionon mbështetur në rregulloren e kësaj njësie, harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies referuar edhe PS Msc në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil “Strukturë”. Ajo është përgjegjëse për “skanimin” e situatës lidhur me cilësinë dhe kompetente për hartimin e strategjive lidhur me përmirësimin e saj. Për këtë ajo harton raporte në çdo fund semestri dhe, në koordinim me departamentet dhe dekanatet në nivel institucional, diskuton mbi konstatimet e gjetura dhe rekomandon masat për përmirësim mbështetur në strategjinë e zhvillimit të institucionit për vitet 2021-2026. Realizimin e kësaj strategjie e gjen qysh tek mjediset ku zhvillohet aktiviteti mësimor e kërkimoro-shkencor, në kompozimin e planit mësimor, në hartimin e syllabuseve të çdo lënde, në rekrutimin e një personeli akademik dhe administrativ me nivel të lartë kualifikimi, dhe në cilësinë e të gjitha shërbimeve. Në takimin me studentët, GVJ u informua për vlersimin e tyre ndaj metodave të mësimdhënies duke shprehur konsideratat të larta.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 16_Broshura_Innovation Factory_IF_Strategy - Aneks 34_Guida e Studentit - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 2. Strukturët përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Njësia kryesore dhe njësia bazë e PS “Msc në Inxhinierinë e ndërtimit me profil strukturë” janë përkatësisht “Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit” dhe “Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë”. Këto Strukturë përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma monitorimi dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. GVJ konsultoi dokumentat e mëposhtme: Vlerësimi i kolegut për kolegun, Formular për vlerësimin, Vetëvlerësim i performances se lektorit, Pyetesor për vlerësimin e pedagogut nga studentet, Formular për vlerësimin e proceseve administrative dhe konstaton që këto formularë plotësohen periodikisht dhe kanë ndikimin e duhur në vlersimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit.</p> <p><i>Referenca:</i></p>



	<p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- Aneks 4_Rregullore Didaktike</p> <p>- Aneks 6_Rregullore e programit të studimit</p> <p>- Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING</p> <p>- Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit</p> <p>- Aneks 17 (1,2,3,4,5) Formularët e vlersimit</p> <p>- Aneks 34_Guida e Studentit</p> <p>- Aneks 35_Rregullore ZMSKK</p> <p>- https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Universiteti Polis garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve, si dhe mundësinë e trajtimit të ankimimeve më së pari nëpërmjet trajtimit të ankesave të tyre. Kjo procedurë bazohet në përcaktimet detyruese të “Rregullores Didaktike”. Më tej nëpërmjet plotësimit të një pyetësi të posaçëm, i cili është depozituar si dokument edhe në platformën “Pitagora” studentët japin vlersimet si dhe shprehin mendimet e tyre për çdo lëndë të frekuentuar. Po kështu duke plotësuar “Pyetësin për vlerësimin e pedagogut nga studentet” i cili përbëhet nga 10 pyetje, ku kërkohen vlersime të studentëve lidhur me performancën e pedagogëve në mësimdhënie, fitohet një tablo e qartë për angazhimin e PAE/PAK dhe marrdhëniet e tyre me auditorin. GVJ konsultoi këtë pyetësor si dhe u interesua të informohet nga studentët lidhur me përfshirjen e tyre në vlersimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve si dhe trajtimin e ankimimeve dhe vlerëson plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- Aneks 4_Rregullore Didaktike</p> <p>- Aneks 6_Rregullore e programit të studimit</p> <p>- Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING</p> <p>- Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit</p> <p>- Aneks 17 (1,2,3,4,5) Formularët e vlersimit</p> <p>- Aneks 34_Guida e Studentit</p> <p>- Aneks 35_Rregullore ZMSKK</p> <p>- https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 4. Strukturët përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Publikimi i rezultateve të të gjitha gjetjeve të anketimit bëhet në faqen zyrtare të Universitetit Polis si “RAPORTI VJETOR (për vlerësimin e procesit mësimor nga studentët)”. GVJ e konsultoi faqen zyrtare të institucionit dhe konstaton publikimin e të dhënave e rezultateve të anketimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- Aneks 4_Rregullore Didaktike</p> <p>- Aneks 6_Rregullore e programit të studimit</p> <p>- Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING</p> <p>- Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit</p>

	<p>- Aneks 17 (1,2,3,4.5) Formularët e vlersimit</p> <p>- Aneks 8_Rregullore NjBSCK</p> <p>- https://www.universitetipolis.edu.al/</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në “Raportin Vjetor (për vlerësimin e procesit mësimor nga studentët)” analizohet situata lidhur me performancën dhe në fund, në rubrikën “Përfundime e Rekomandime” evidentohen gjetjet dhe rekomandohet trajtimi i tyre.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- Aneks 4_Rregullore Didaktike</p> <p>- Aneks 6_Rregullore e programit të studimit</p> <p>- Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING</p> <p>- Aneks 12_Strategjia e zhvillimit të programit</p> <p>- Aneks 17 (1,2,3,4.5) Formularët e vlersimit</p> <p>- Aneks 8_Rregullore NjBSCK</p> <p>- https://www.universitetipolis.edu.al/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të Strukturëve e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, Strukturë dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ konstaton që në Universitetin Polis është ngritur e funksionon Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përputhje me nenin 103 të Ligjit nr. 80/2015. Mbi këtë bazë janë hartuar aktet rregullatore të institucionit si Statuti, Rregullorja Didaktike, Rregulloret e Njërive Kryesore, Rregulloret e Programeve të Studimeve etj, të cilët kanë prodhuar strukturën e cilësisë ku përfshihen Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjBSC) dhe Komisioni i Rishikimit të Kurrikulave. Kjo strukturë ka si produkt funksionimin, zhvillimin dhe realizimin e procesit mësimor e kërkimoro-shkencor me nivel të tillë cilësie, që të diplomuarit e tij të kërkohen dhe të pranohen nga tregu i punës vendas dhe i huaj.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- Aneks 4_Rregullore Didaktike</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1.2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, DVV si dhe të gjitha produktet e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, GVJ gjykon që institucioni e ka të ngritur dhe e mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. E gjithë Strukturë e tij zbaton strategjinë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke përfshirë edhe studentët edhe ekspertë të jashtëm si anëtarë të kësaj strukture.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1,2,3,4,5) Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Akreditimet nga ASCAL të Universitetit Polis janë kryer sipas dispozitave ligjore për arsimin e lartë në vendin tonë. Gjetjet dhe rekomandimet e këtyre akreditimeve, mbështetur në treguesit e cilësisë të realizuar prej tij, kanë shërbyer në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë edhe për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”. GVJ shqyrtoi rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.12 datë 30.08.2018 dhe konstaton konsiderimin dhe plotësimin e tyre.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1.2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për</p>	<p>Referuar DVV, RVB dhe vizitës në Universitetin Polis GVJ konstaton përdorimin e treguesve të qartë për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore të institucionit. Këto tregues pasqyrohen në raportet periodike që harton institucioni dhe njësitë përbërse të tij. Ato janë të publikuar në adresën e faqes zyrtare të Universitetit Polis https://www.universitetipolis.edu.al/, kështuqë mund të konsultohen prej cilitdo të interesuari, i cili pas konsultimit konstaton që ky institucion, mbështetur në treguesit cilësorë bën promovime nxitëse për arritjet më të mira edhe në programin e studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”.</p>

arritjet më të mira në programin e studimit.	<i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1,2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të Strukturëve e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konsultoi fillimisht DVV, që ka shërbyer si bazë e punës së Grupit të Vlersimit të Brendshëm për hartimin e RVB dhe konstatoi që kjo dosje përmban dokumentat e përcaktuara në aktet ligjore për evidentimin e nivelit të cilësisë në PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”. Në vazhdim, gjatë vizitës në institucion, u kërkuan edhe disa dokumenta shtesë. Në shqyrtim dhe në analizë të gjithë këtyre materialeve, GVJ konstaton që dokumentat e prodhuara i shërbejnë akreditimit të PS.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1,2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 32_Raporti Vjetor NJBSC 2022-2023 - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e</p>	<p>GVJ konstaton që në RVB, të prodhuar nga Grupi i Vlersimit të Brendshëm (GVB) si dhe në gjithë dokumenatcionin e prodhuar nga zbatimi i akteve rregulluese ligjore përfshihen rezultate vlersimi, motivohen praktikat dhe arritjet më të mira, pasqyrohen masat e marra për përmirësimin në vijim të cilësisë si dhe motivohen arritjet më të mira në</p>

<p>marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>procesin mësimor dhe kërkimor shkencor nga i gjithë personeli akademik i angazhuar me PS "Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1,2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 32_Raporti Vjetor NJBSC 2022-2023 - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstaton që vizitat në auditore, si një metodë e drejtpërdrejtë, evidentojnë probleme që kanë të bëjnë me komunikimin e pedagogëve me auditorin, aktivizimin e studentëve, përdorimin e kohës në mësimdhënie etj. Përveç këtij vlersimi një rol të rëndësishëm luan edhe evidentimi i rezultateve të pyetsorit për vlersimin e lektorëve nga ana e studentëve. Pyetjet e anketimit në këtë formular lidhen me performancën e lektorit në auditor, ku me sistemin e pikëve nga 1 deri 5 nxirren konkluzione e merren masa për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie. Pesha e këtij vlersimi është 50%. GVJ konsultoi faqen zyrtare të institucionit dhe konstatoi kryerjen periodike të këtij vlersimi.</p> <p>Më tej procesi i vlersimit tek U_Polis realizohet edhe me vlersimin midis kolegëve ku kolegu vlerson kolegun (pesha e këtij vlersimi në performancë është 35%) dhe vetëvlersimin (me peshë 15%) ku çdo lektor jep vlersimin për veten e tij.</p> <p>Në kuadër të vlersimve përfshihen edhe vlersimi nga drejtuesit, vlersimi me sondazhe, vlersimet me ballafaqim me tregun e punës etj</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1,2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 32_Raporti Vjetor NJBSC 2022-2023 - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti Polis monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Referuar Ligjit 80/2015 si dhe akteve rregullore ligjore të institucionit që burojnë nga zbatimi i këtij ligji, Statutit dhe Rregulloreve të tij, GVJ konstaton që në Universitetin Polis, në politikat dhe procedurat lidhur me sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”, parashikohet dhe garantohet përfshirja e aktorëve të brendshëm e të jashtëm. Kështu në organet që merren me sigurimin e cilësisë, si aktorë të brendshëm janë edhe studentët. Kontrolli i cilësisë bëhet periodikisht edhe nga ASCAL nëpërmjet akreditimeve.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1,2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - Aneks 52_Internal_Quality_Assurance_Strategy_2023-2027- - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në aktet ligjore dhe rregullore të institucionit përcaktohen të drejta dhe detyrime për të gjithë aktorët që merren me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në zbatim të këtyre përcaktimeve ligjore kryhen auditime të vazhdueshme rezultatet e të cilave publikohen edhe në Raportin Vjetor të Institucionit. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton që përgjegjësi dhe detyra konkrete në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë” kanë: Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit, Departamenti i Arkitekturës e Inxhinierisë, Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit, Staf i akademik i rekrutuar për mësimdhënien, Staf i administrativ i rekrutuar për shërbimet. Të gjithë këto përbërës, përfshirë edhe studentët, me angazhimin e tyre në vlersim të mësimdhënies dhe arritjes së rezultateve në përvetësimin e dijeve që ofron Universiteti, realizojnë detyrimet e tyre në sigurimin e brendshëm të cilësisë. GVJ gjykon që ky kriter për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë” plotësohet tërësisht.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1.2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>GVJ, duke shqyrtuar DVV dhe RVB si dhe gjatë takimeve në institucion, gjykon që njësitë përgjegjëse për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë”: -Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit; Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë si dhe drejtuesit e tyre janë të angazhuar për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Ata, nëpërmjet përcaktimit të qartë të detyrave e përgjegjësive, kontrollit të zbatimit të tyre, respektimit të afateve kohore në realizimin e përgjegjësive, në bashkëpunim edhe me studentët, kanë krijuar një trupë aktive, puna e së cilës është shpërblyer me rezultate të larta si gjatë viteve të studimit ashtu e, kryesisht, në tregun e punës.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1.2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Si aktorë të brendshëm në proceset e vlersimit të PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë” konsiderohen Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit, Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, stafi akademik, stafi administrativ si dhe studentët. Duke shqyrtuar DVV si dhe gjatë vizatave në institucion GVJ konstaton që të gjithë këta aktorë janë përfshirë në procesin e vlersimit dhe detyrat që ata kanë kryer, kanë qenë të barazvlefshme në cilësi duke shmangur diskriminimin dhe pabarazinë.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1.2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose</p>	<p>Si aktorë të jashtëm në procesin e vlersimit konsiderohen përfaqësues nga sipërmarrjet ku janë punësuar të diplomuarit e këtij programi studimi, antarët e Aluminit, ekspertët e akreditimit si dhe publiku i interesuar dhe i informuar mbi këtë program. GVJ konstaton që të gjithë këta aktorë kanë</p>

<p>ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>dhënë kontributin e tyre me ekspertizë e mendime të çmuara në lidhje me cilësinë dhe përmirësimin e saj.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit të programit - Aneks 17 (1,2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - Aneks 52_Internal_Quality_Assurance_Strategy_2023-2027 - https://www.universitetipolis.edu.al/ 			
<p>Konkluzione</p>	<p>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.5</p>	
<p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë” janë dokumentuar në aktet ligjore e nënligjore të Universitetit Polis. Në pikpamje të realizimit, ato përbëjnë sfida të mëdha, kryesisht me konkurrencën brenda e jashtë vendit lidhur me kontigjentet dhe tregun e punës. Instituti ka interes që këto elementë të aktivitetit të tij të jenë transparente e të njihen gjerësisht. Për këtë, përveç botimeve në fashikuj të veçantë përfshirë në dokumentat bazë të institucionit ato janë publikuar edhe në faqen zyrtare të institucionit https://www.universitetipolis.edu.al/.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit të programit - Aneks 17 (1,2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 48_Raporti Vjetor 2022-2023

	<p>- <i>Aneks 52 Internal Quality Assurance Strategy 2023-2027</i> - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Universiteti Polis i ka botuar rezultatet e e vlerësimeve “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë” në kapituj të veçantë të përfshirë në dokumentat bazë të institucionit apo raportet vjetore, si broshura më vehte si dhe në faqen zyrtare të institucionit https://www.universitetipolis.edu.al/. Gjatë vizitës në institucion, kryesisht në takimin me Personelin Akademik, GVJ u insteresua për respektimin e lirisë dhe etikës akademike dhe konstatoi respektimin e tyre. Po ashtu është respektuar dhe legjislacioni për ruajtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 Rregullore Didaktike - Aneks 6 Rregullore e programit të studimit - Aneks 7 Rregullore Diplomimi Msc ING - Aneks 12 Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1.2.3.4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 48 Raporti Vjetor 2022-2023 - Aneks 52 Internal Quality Assurance Strategy 2023-2027 - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në raportet vjetore, por edhe në analizat lidhur me rezultatet e vlerësimit, janë hartuar plane masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. GVJ konstaton që raportet e vlerësimit të jashtëm shqyrtohen nga drejtuesit e njësive përgjegjëse, përkatësisht programeve të studimit, të cilët kanë kompetencën dhe përgjegjësinë, në zbatim të detyrimeve ligjore, të hartojnë plane veprimi duke caktuar objektiva dhe afate konkrete. Plane veprimi hartohen edhe duke adresuar gjetjet e anketimeve si anketimet për vlersimin e lektorëve etj.</p> <p><i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 Rregullore Didaktike - Aneks 6 Rregullore e programit të studimit - Aneks 7 Rregullore Diplomimi Msc ING - Aneks 12 Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1.2.3.4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 48 Raporti Vjetor 2022-2023 - Aneks 52 Internal Quality Assurance Strategy 2023-2027 - https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në</p>	<p>Universiteti Polis, nëpërmjet Strukturëve të tij, që lidhen direkt me vlersimin e cilësisë shqyrton akte dhe procedura të cilat miratohen nga Senati Akademik. Pas miratimit, zbatimi i këtyre akteve dhe procedurave është i detyrueshëm. GVJ gjykon që procesi i zbatimit ka qenë efektiv dhe ka çuar në përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”</p>

përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1,2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 48_Raporti Vjetor 2022-2023 - Aneks 52_Internal_Quality_Assurance_Strategy_2023-2027 - https://www.universitetipolis.edu.al/ 			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në shqyrtim të DVV dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Universiteti Polis organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Në takimin me personelin akademik, psh u pohua që rezultatet e anketimeve ndikonin direkt në ndërgjegjësimin e tyre lidhur me natyrën e gjetjeve dhe motivimin e tyre për tu ngjitur më lart në nivelet e vlersimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 7_Rregullore Diplomimi Msc_ING - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 (1,2,3,4.5) Formularët e vlersimit - Aneks 48_Raporti Vjetor 2022-2023 - Aneks 52_Internal_Quality_Assurance_Strategy_2023-2027 - https://www.universitetipolis.edu.al/ 			
Konkluzione	<p>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që në Universitetin Polis politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit "Msc në Inxhinierinë e Ndërtimit me profil strukturë" janë publike, transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Inxhinieri Ndërtimi” me profil Strukturë ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Polis”

Pikat e forta dhe afirmime:


- 1) Personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në këtë program studimi, referuar jo vetëm dokumentacionit por edhe vlersimeve nga studentët, e zhvillon aktivitetin e tij në plotësim të kërkesave e detyrimeve kontraktuale, në plotësim të nevojave institucionale si dhe duke konsideruar në vazhdimësi sugjerimet për rritjen e cilësisë si në procesin e mësimdhënies ashtu edhe në atë të kërkimit shkencor.
- 2) Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor edhe për programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë” janë të bollshme, të përshtatshme, të mirëpajisura dhe inkurajuese për rritjen e vëmendjes dhe përqëndrimit nga ana e studentëve. Angazhimi institucional për të shtuar ambientet egzistuese me hapsira të reja është një tregues domethënës për sigurimin e një perspektive akoma më të mirë të procesit mësimor e kërkimor shkencor në Universitetin Polis përkatësisht edhe për PS “Msc në inxhinieri ndërtimi me profil strukturë”.
- 3) Bashkëpunimi i strukturuar i Universitetit Polis, edhe në kuadrin e PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi profili structure”, me institucionet dhe organizatat partnere, i kategorizuar si bashkëpunim për praktikat profesionale, bashkëpunim për vizita studimore dhe punë laboratorike si dhe bashkëpunim për shkëmbim kapacitetesh dhe njohurish teknike i jep procesit mësimor përmbajtje më konkurruese dhe pasuron vlerat njohëse e aplikative të studentëve të këtij programi.
- 4) Punësimi “në përputhje me diplomën” në masën mbi 90% i të diplomuarve të këtij PS, është tregues shumë domethënës për vlerën e kurrikulës, përmbajtjen e syllabuseve, objektivitetin e vlersimeve dhe emrin e mirë që, për këto arsye, ka Universiteti Polis.
- 5) Pozicioni i konsoliduar në tregun e punës përbën një motiv të fortë që PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profil strukturë” në Universitetin Polis, të jetë i preferuar në raport me konkurrencën, për kontigjentet që duan të studiojnë në profilet që ofron ai.
- 6) Përdorimi i programeve aplikative (software) për modelimin inxhinierik 3D të ndërtimeve krijon hapsirë me dimensione avantazhuese si për procesin mësimor ashtu edhe për punën kërkimor shkencore.

Pika të dobta:

- 1) Angazhimi i diskutueshëm si PAE i stafit me gradë shkencore Msc, si dhe i ngarkesës prej 25.8% që ai duhet të përballojë në mësimdhënie, vlerësohet që cënon nivelin e cilësisë së mësimdhënies. **(Standardi IV.1, kriteret 1).**
- 2) Duke marrë në konsideratë që peshën kryesore të financimit të këtij programi e përbajnë tarifatat e studentëve në masën 88%), një zvogëlim i mundshëm i numrit të tyre, do të kërkojë rritjen e tarifës deri në nivel ose të papërbalueshëm ose jo interesante në raport me konkurrencën. **(Standardi IV.5, kriteri 2).**

Rekomandime:

- 1) Të shikohet mundësia e përmbushjes së plotë të kërkesës së ligjit 80/2015, neni 59, pika 6.
- 2) Të zgjidhet problemi i qëndrueshmërisë numerike të personelit akademik efektiv si dhe i ngarkesës suplementare të tij nëpërmjet ofertave motivuese.
- 3) Të rritet pesha e financimeve nga burime të tjera për të lehtësuar ngarkesën financiare në tarifën e studimeve.



Conclusions of the Evaluation of the second cycle Master of Science study program "Construction Engineering with Structural" profile" offered by the Higher Education Institution "Polis University".

Strengths and affirmations:

- 1) The effective and contracted academic personnel engaged in this study program, referring not only to the documentation but also to the evaluations by the students, develops its activity in fulfillment of the requirements and contractual obligations, in fulfillment of the institutional needs as well as continuously considering the suggestions for increasing the quality both in the teaching process and in that of scientific research.
- 2) The environments where the learning process takes place also for the PS "Schkencor Master in Structural Engineering" are ample, suitable, well equipped and encouraging for the increase of attention and concentration on the part of the students. The institutional commitment to increase the existing premises with new spaces is a significant indicator for ensuring an even better perspective of the teaching and scientific research process at Polis University, namely for the PS "Msc in construction engineering with structure profile".
- 3) Structured cooperation of Polis University, also in the framework of PS "MSc in Construction Engineering profile structure, with partner institutions and organizations, categorized as cooperation for professional practices, cooperation for study visits and laboratory work as well as cooperation for capacity exchange and of technical knowledge gives the learning process more competitive content and enriches the cognitive and application values of the students of this program.
- 4) Employment "in accordance with the diploma" in the amount of more than 90% of the graduates of this SP, is a very significant indicator for the value of the curriculum, the content of the syllabuses, the objectivity of the evaluations and the good name that, for these reasons, Polis University has.
- 5) The consolidated position in the labor market constitutes a strong motive for the SP "Msc in Civil Engineering with structure profile" at Polis University to be preferred in relation to the competition, for contingents who want to study in the profiles it offers.
- 6) Participation and activation of students in the educational program of application programs (software) for engineering 3D modeling of constructions.

Weaknesses:

- 1) The controversial commitment as PAE (in this PS) of the staff with a scientific Msc degree, as well as the load of 25.8% that he has to bear in teaching, is estimated to affect the level of teaching quality. (Standard IV.1, criteria 1).
- 2) Taking into consideration that the main weight of the financing of this program is comprised of student fees in the amount of 88%), a possible reduction in their number will require the increase of the fee to the level that is either unaffordable or uninteresting in relative to the competition. (Standard IV.5, criteria 2).

Recommendation:


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Faqe 84



- 1) To consider the possibility of fully fulfilling the requirement of Law 80/2015, Article 59, Point 6.
- 2) To solve the problem of the numerical stability of the effective academic staff as well as of his supplementary load through motivational offers.
- 3) To increase the weight of funding from other sources to ease the financial burden on the study fee.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI i PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI i PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRA STRUKTURË, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI i CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

